

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2022



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.


Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS**

RAPORTI I VITIT 2022




**KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS &
SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE**



Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	4
Parathënie	6
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	8
Masat e KOVID-19	20
DHOMAT	22
1. Aktivitetet gjyqësore	23
2. Kryetarja dhe gjykatësit	36
3. Aktivitetet e Jashtme	38
MARRËDHËNIET ME JASHTË	40
ZYRA ADMINISTRATIVE	44
1. Kabineti i Administratores	49
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	50
2.1 Marrëdhëniet me mediat	51
2.2 Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim	53
2.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjetin e Informimit të Gjykatës	54
2.4 Informacioni publik për DHSK-në	54
3. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	55
4. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	57
4.1 Njësia e Administrimit të Gjykatës	57
4.2 Njësia e Përkthimit	58
4.3 Zyra e Mbrojtjes	58
4.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	59
4.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	60
4.6 Njësia e Paraburgimit	61
5. Seksioni i Administratës	63
5.1 Njësia e Burimeve Njerëzore	63
5.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit	66
5.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	67
5.4 Njësia e Sigurisë	68
5.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit	69
5.6 Njësia e Prokurimit	70
6. Zyra e Auditimit	71
INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS	72
1. Integrimi i perspektivës gjinore dhe barazia në DHSK dhe ZPS	73
2. Personi i kontaktit për çështje gjinore	76
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	78
1. Parathënie	80
2. Mandati i ZPS-së	81
3. Zbatimi i mandatit	82
4. Prokurori i Specializuar Xhek Smith	87
5. Kuadri udhëheqës i Prokurorisë	88
6. Ekipet e Prokurorisë	90



Dhomat e Specializuara të Kosovës



Është kënaqësi për ne t'ju paraqesim raportin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) për vitin 2022. Puna vazhdoi me intensitet të njëjtë dhe ritëm të efektshëm në të katër çështjet gjyqësore para DHSK-së. Gjatë këtij viti pati zhvillime gjyqësore të konsiderueshme, si lëshimi i dy aktgjykimeve dhe kalimi i dy çështjeve gjyqësore nga faza paraprake në fazën e gjykimit. Shtimi i konsiderueshëm i aktiviteteve gjyqësore, si dhe arritjet e ndryshme gjatë gjithë vitit janë dëshmi e përkushtimit të gjykatësve të DHSK-së, anëtarëve të personelit dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës, të cilët i kryen detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe efikase.

Edhe pse pandemia e shkaktuar nga KOVID-19 vijoi të ndikonte në veprimtarinë gjyqësore deri në fillim të majit – kur u hoqën të gjitha masat dhe shumica e punonjësve u kthyen në zyrat e tyre – gjatë vitit 2022 veprimtaritë gjyqësore të DHSK-së vazhduan të shtoheshin. Konkretisht, përfunduan dy procese gjyqësore dhe u lëshuan dy aktgjykime në ato çështje gjyqësore. Një prej këtyre çështjeve gjyqësore kaloi në fazën e apelit. Dy çështje gjyqësore të tjera Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi trupave gjykues përkatës. Për herë të parë që kur DHSK-ja u bë funksionale nga aspekti gjyqësor, panele në të gjitha nivelet gjyqësore ishin të ngarkuar me shqyrtimin e çështjeve të ndryshme gjyqësore. Në fakt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Panelet e Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Supreme dhe Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, ishin që të gjithë aktivë gjatë vitit 2022 dhe lëshuan një numër të madh vendimesh dhe urdhrash të ndryshëm.

Gjithashtu, në mars gjykatësit e DHSK-së mbajtën seancën e tyre plenare përmes videokonferencës, gjatë së cilës morën informacion të përditësuar mbi çështje të rëndësishme institucionale dhe trajtuan tema të ndryshme të rendit të ditës të seancës plenare. Gjykatësit u mblodhën gjithashtu edhe në maj – që ishte mbledhja e parë e tyre me prani fizike që nga fillimi i pandemisë, gjatë së cilës u bë edhe përirimi zyrtar i sallës së gjyqit.

Bashkëpunimi dypalësh me shtetet është me rëndësi jetike për t'i mundësuar DHSK-së përmeshjen e mandatit të vet. Duke pasur parasysh përparimin e arritur në veprimtaritë gjyqësore, në maj, Kryetarja miratoi Udhëzuesin e Punës për Caktimin e Shtetit për Kryerjen e Dënimit. Që nga ajo kohë, Administratorja ka pasur angazhime diplomatike dypalëshe intensive për lidhjen e marrëveshjeve për kryerje të dënimit.

Në shtator, Kryetarja udhëtoi në Kosovë për t'u takuar me shoqërinë civile, median dhe të tjerë për t'u dhënë informacion lidhur me proceset aktuale dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me Gjykatën dhe mandatin e saj. Kryetarja i çmon shumë komentet që mori në këto mbledhje.

Ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim vazhdoi organizimin e aktiviteteve të shumta, si në Kosovë ashtu edhe përmes videokonferencës, me anëtarë të ndryshëm të shoqërisë civile në Kosovë. Gjithashtu, DHSK-ja priti në ambientet e saj Rrjetin e Informimit të Gjykatës (RRIGJ) për një punëtorë dyditësh, gjatë së cilës Kryetarja dhe Administratorja u dhanë informacion anëtarëve të RRIGJ-së për përmbajtjen dhe efektivitetin e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të Gjykatës dhe morën komente të vyer në lidhje me të. Falë kontributit financiar bujar të qeverisë zvicerane, DHSK-ja është në gjendje të zhvillojë këtë program kaq gjithëpërfshirës për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Si rezultat i aktiviteteve gjyqësore të zhvilluara në DHSK, ka pasur interesim të vazhdueshëm për punën e saj. DHSK-ja mbetet e përkushtuar për të mundësuar qasje transparente në informacion lidhur me proceset e saj. Për këtë qëllim, DHSK-ja ka vazhduar të publikojë materiale informative lidhur me mandatin e saj, përfshirë një fletë informative me titull "Një përshkrim i shkurtër i DHSK-së". Gjithashtu, DHSK-ja ka mundësuar që të gjitha proceset të mund të ndiqen ose përmes transmetimit në kohë reale në faqen e saj të internetit, ose përmes kanalit të saj në YouTube. Punonjësit e Njësisë për Informim dhe

Komunikim me Publikun të DHSK-së janë gjithmonë të disponueshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve, qoftë nga përfaqësues të mediave apo të shoqërisë, dhe më 16 tetor, gjatë Ditës së Vizitave Paqe e Drejtësi, DHSK-ja hapi dyert për publikun për të vizituar sallën e gjyqit, si edhe për të bërë pyetje mbi institucionin.

Në dhjetor u shënua edhe një arritje tjetër me miratimin e Udhëzimit kundër Ngacmimeve, që ishte shprehje e përkushtimit tonë për një mjedis pune të sigurt dhe përfshirës. Ne zbatojmë praktikën e tolerancës zero ndaj çdo lloj ngacmimi dhe kjo direktivë e re është kurorëzimi i punës disavjeçare për rritjen e vetëdijesimit dhe forcimin e kornizës për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit në DHSK, që filloi me miratimin e Rregullores për Punonjësit dhe Kodin e Etikës në 2016, Procedurën Standarde për Procesin Disiplinor, si dhe me Strategjinë kundër Ngacmimeve më 2019, bashkë me instrumente ligjore të tjera mbi standardet profesionale. Në kuadër të traditës së DHSK-së për dinjitet dhe respekt të ndërsjellë, ishte arritje që Njësia e Burimeve Njerëzore ofroi trajnime të posaçme për të gjithë punonjësit lidhur me parandalimin e ngacmimit psikologjik dhe seksual dhe të paragjyqimeve të pavetëdijshme.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, dhjetor 2022

Dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve të treta kontribuese për mbështetjen e vazhdueshme për DHSK-në gjatë vitit 2022. Gjithashtu i jemi mirënjohës Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë për mbështetjen e dhënë gjatë operacioneve të kryera atje, si edhe Policisë së Kosovës për ndihmën e saj në këtë aspekt.

Njëkohësisht u shprehim mirënjohje homologëve të DHSK-së në Shërbimin e Jashtëm të BE-së, në Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe Zyrën e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil, për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre me DHSK-në gjatë vitit.

Po kështu, u jemi mirënjohës shteteve, trupit diplomatik si dhe gjykatave ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara në Hagë për shkëmbimet konstruktive për çështje organizative dhe administrative.

Mirëpresim vitin që kemi përpara, në të cilin DHSK-ja do të vazhdojë t'i kryejë proceset në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e saj.

Dr. Fidelma Donlon
Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në **janar 2011**, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në **shtator 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, në **prill 2014** u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcakton se këto dhoma të dedikuara dhe të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, dhe do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se këto dhoma të veçanta gjyqësore do të kishin seli në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.

Në **korrik 2014**, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhet se “TFHS-ja do të jetë një gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhet të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar pakësonte ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themelitar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, që shënoi fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, z. Dejvid Shvendiman (David Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së dhe filloi punën në janar 2017.

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, nëntëmbëdhjetë gjykatës u emëruan në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 234 avokatë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.


Në **maj 2018**, z. Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i Informimit të Gjykatës, në të cilin bëjnë pjesë OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas z. Dejvid Shvendiman, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua z. Xhek Smith (Jack Smith).

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në zyrat e reja në Hagë.



Në **shkurt** dhe **prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u riemërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020** bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Më **16 mars 2021**, z. Pjetër Shala u arrestua në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më **15 prill 2021**.

Më **5 maj 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjykses I për çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës* dhe gjykimi filloi më **15 shtator 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **15 korrik 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjykses II në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* dhe gjykimi filloi më **7 tetor 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **8 maj 2022**, Prokurori i Specializuar Xhek Smith u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Më **18 maj 2022**, Trupi Gjykses II shqiptoi aktgjykimin e parë në DHSK në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* duke i shpallur të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Më **17 qershor 2022**, z. Gucati dhe z. Haradinaj dorëzuan njoftimet përkatëse për apel kundër aktgjykimit.

Më **21 shtator 2022**, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës* Trupit Gjykses I.

Më **19 nëntor 2022**, pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting (Alex Whiting) u emërua Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

Më **1 dhe 2 dhjetor 2022**, Paneli i Gjykatës së Apelit mbajti seanca të apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.

Më **15 dhjetor 2022**, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve Trupit Gjykses II.

Më **16 dhjetor 2022**, Trupi Gjykses I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, duke e shpallur të akuzuarin fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës, dhe vrasjes së paligjshme.

Kronologjia



JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

SHTATOR 2011

Filloi punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE.

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

GUSHT 2015

Asambleja e Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.



DHJETOR 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

SHTATOR 2016

Z. Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, që shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.

Kronologjia

JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.



SHKURT 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

KORRIK 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe të Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.



SHTATOR 2018

Z. Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas z. Dejvid Shvendiman.



MAJ 2018

Z. Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

NËNTOR 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së.



QERSHOR 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në ndërtesat e reja.

SHKURT DHE PRILL 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.

PRILL 2020

Administratorja Fidelma Donlon rimërohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

SHTATOR 2020

Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.



SHTATOR 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

DHJETOR 2020

Kryetarja Ekaterina Trendafilova rimërohet për një mandat katërvjeçar.

NËNTOR 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi për krime të pretenduara kundër njerëzimit dhe për krime lufte.

Kronologjia



MARS DHE PRILL 2021

Z. Pjetër Shala arrestohet në Belgjikë dhe transferohet në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

TETOR 2021

Fillon procesi i gjyimit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



MARS 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



QERSHOR 2022

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj dorëzojnë njoftimet për apel kundër aktgjyimit.

MAJ 2022

Trupi Gjykues II shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.

MAJ 2022

Prokurori i Specializuar Xhek Smith riemërohet për një mandat katërvjeçar.

SHTATOR 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

**SHTATOR 2022**

Trupit Gjykues I i kalohet çështja gjyqësore
Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

**NËNTOR 2022**

Pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting
emërohet Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të
Specializuar.

**DHJETOR 2022**

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin e parë të
DHSK-së për krime lufte në çështjen gjyqësore
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës


**DHJETOR 2022**

Trupit Gjykues II i kalohet çështja gjyqësore
*Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe
të tjerëve.*

**DHJETOR 2022**

Seanca e apelit në çështjen gjyqësore
*Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim
Haradinajt.*

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas Shkëmbimit të Letrave në përputhje me legjislacionin e Kosovës, me anë të amendamentit kushtetues më 2015. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlihen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit).

■ DHSK-ja u krijua në përputhje me Shkëmbimin e Letrave dhe legjislacionin e Kosovës, dhe

- ka të njëjtat shkallë gjykimi si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese)
- ka seli jashtë Kosovës
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuese
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikurse përcaktohet në Ligj
- zbaton rregulloren e vet të procedurës dhe provave.

■ DHSK-ja është institucion gjyqësor i përkohshëm

- që do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.


■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve
- që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
- që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

■ DHSK-ja merret vetëm me përgjegjësi penale individuale - nuk mund të gjykohen grupe ose organizata.

■ DHSK-ja lejon pjesëmarrjen e viktimave në procese gjyqësore.

- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.
- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.
- DHSK-ja ka **Avokatin e Popullit**, i cili vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në, ndër të tjera
 - përmes procedurës së parashtrimit të ankesave prej personave
 - në qoftë se ankesa e tyre ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në
 - në rast të vonesave të paarsyeshme të një procesi në DHSK
 - në qoftë se janë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike
 - në qoftë se ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar
- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.







Masat e KOVID-19


Në maj 2022, pas lehtësimit të masave të KOVID-19 nga shteti pritës, të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së u kthyen të punonin në zyrat e tyre. Kanë kaluar mbi dy vjet që kur për shkak të pandemisë, shumica e punonjësve u detyruan të punojnë nga distanca. Me gjithë masat e ndryshme në fuqi, DHSK-ja dhe ZPS-ja vijuan të ushtrojnë mandatin e tyre pa ndërprerje gjatë gjithë pandemisë.

Më 15 mars 2022, qeveria holandeze njoftoi për lehtësimin e masave kufizuese lidhur me KOVID-19, dhe heqjen e këshillës për të punuar nga shtëpia. Si rezultat, u zbatua plani për rikthimin e sigurt në zyrë, me orar të plotë, të punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së. Punonjësit u njoftuan më 18 mars 2022 se do të ktheheshin në zyrë në ndërtesat e DHSK-së dhe ZPS-së nga 2 maji 2022 dhe në vijim, me një periudhë kalimtare që punonjësit të bënin përgatitjet e nevojshme. U hartua edhe një direktivë e posaçme administrative, që u rishikua në prill 2022, sipas së cilës punonjësit që punojnë me orar të plotë në zyrë, mund të bëjnë kërkesë për të punuar nga distanca jo më shumë se dy ditë në javë, në varësi, ndër të tjera, të nevojave të punës dhe interesave të DHSK-së dhe ZPS-së. Përjashtime nga rregulla për punë me orar të plotë në zyrë mund të bëhen edhe për arsye shëndetësore.

Pas kthimit të të gjithë punonjësve në zyrë në fillim të majit 2022, DHSK-ja dhe ZPS-ja vazhduan t'i përcillnin me vëmendje masat dhe njoftimet e shtetit pritës në lidhje me pandeminë e KOVID-19. Më 27 maj 2022, në përputhje me udhëzimet e shtetit pritës, punonjësit u njoftuan për ndryshimet në masat e KOVID-19, të cilat filluan të zbatoheshin në DHSK dhe ZPS më 30 maj 2022. Këto ndryshime përfshinin heqjen e detyrimit për mbajtjen e maskës në mjediset e brendshme dhe të kriterit për respektimin e distancës. Edhe pse masat u hoqën, punonjësit dhe vizitorët sigurisht që mund të vazhdonin t'i zbatonin ato në rast se dëshironin. Organizata vazhdoi t'i nxiste punonjësit që të ishin të kujdesshëm dhe të mbanin parasysh mirëqenien e kolegëve.

Ndërkohë u pezullua edhe zbatimi i dy udhëzimeve operative lidhur me KOVID-19. Kjo do të thoshte gjithashtu se galeria për publikun u hap përsëri plotësisht për këdo që dëshironte të ndiqte seancat si dhe u hoq edhe kriteri për regjistrim paraprak dhe plotësimin e pyetësorit për KOVID-19.

Masat teknike që u zbatuan për shkak të pandemisë, të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e palëve në proces nga distanca, mbetën në fuqi gjatë gjithë vitit 2022. Po kështu, të paraburgosurit vazhduan të kishin mundësinë e vizitave përmes video, si alternativë e vizitave personale.





Dhomat



1 | Aktivitetet gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) patën veprimtari gjyqësore mjaft aktive më 2022, vit në të cilin u shënuan një numër arritjesh të konsiderueshme. Konkretisht, gjatë këtij viti doli aktgjykimi i parë në DHSK, nga Trupi Gjyqësor II në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, si dhe filloi procesi i parë i apelit në po atë çështje gjyqësore. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kaloi për gjykim çështjet gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës dhe Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve*. Po kështu, u lëshua edhe aktgjykimi i parë për krime lufte nga Trupi Gjyqësor I në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*.

Për herë të parë që kur DHSK-ja u bë funksionale në aspektin gjyqësor, gjatë vitit 2022, panele gjyqësore në të gjitha nivelet e Dhomave të Specializuara ishin të ngarkuar me shqyrtime çështjesh gjyqësore: Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dy Trupa Gjyqësorë, Paneli i Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Supreme dhe Dhomat e Specializuara të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK). Gjatë vitit, këto panele lëshuan 659 vendime dhe urdhra, ndër të cilët 89 urdhra gojorë.

PROCESET PARA TRUPAVE GJYKUES

Gjatë vitit 2022 përfunduan dy procese gjyqësore dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake ua kaloi dy çështje gjyqësore Trupave Gjyqësorë.



Gjykatësi i Procedurës Paraprake



Trupi Gjykues I



Trupi Gjykues II

I.

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Aktakuza e ngarkon z. Salih Mustafa me katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme) të kryera në prill 1999. Sipas aktakuzës, gjatë periudhës përkatëse, z. Mustafa ishte komandant i një njësi të gueril në Zonën Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Z. Mustafa u arrestua në Kosovë më 24 shtator 2020 dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së po atë ditë.

Gjatë procesit të gjyimit, që vazhdoi për 53 ditë që nga fillimi i tij më 15 shtator 2021, u dëgjuan 29 dëshmitarë. Tetë viktimat u pranuan si viktimat pjesëmarrëse në këtë proces, që u përfaqësuan të gjithë nga një mbrojtëse e viktimave. Trupi Gjykues shpalli zyrtarisht mbylljen e fazës së paraqitjes së provave më 20 qershor dhe deklaratat përmbyllëse u mbajtën më 13 dhe 15 shtator 2022 – saktësisht një vit pas deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar.



Z. Salih Mustafa gjatë konferencës përgatitore për gjykim, 9 qershor 2021



Shqiptimi i aktgjykimit në çështjen gjyqësore kundër z. Salih Mustafa, 16 dhjetor 2022

Trupi Gjykses i përbërë nga gjykatësit Mapi Feld-Folia (kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë), shqiptuan aktgjykimin në këtë çështje gjyqësore më 16 dhjetor 2022. Ky është aktgjykimi i parë i Dhomave Specializuara për krime lufte.

Trupi Gjykses e shpalli z. Mustafa fajtor për torturë, ndalim arbitrar dhe vrasje të paligjshme si krim lufte dhe e dënoi me 26 vite burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim. Trupi Gjykses e shpalli z. Mustafa të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte.

Në këtë çështje gjyqësore, akuzat e paraqitura nga Prokurori i Specializuar kanë të bëjnë vetëm me përgjegjësinë penale individuale të z. Mustafa dhe pjesëmarrjen e tij në krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, të paraqitura në aktakuzën e Prokurorit të Specializuar. Në asnjë moment nuk u gjykua Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Viktimat që pretendohet se pësuan dëm si pasojë e veprimeve të z. Mustafa, janë qytetarë të Kosovës dhe të përkatësisë etnike shqiptare. Përpjekjet e tyre për të kërkuar drejtësinë dhe të vërtetën janë thelbi i këtij procesi.

Trupi Gjykses ka dëgjuar disa dëshmi të dorës së parë nga dëshmitarë. Disa nga ata janë gjithashtu edhe viktima pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor. Këta dëshmitarë dëshmuar për ngjarjet traumatike që ata përjetuan dhe ndikimin e vazhdueshëm psikologjik të këtyre ngjarjeve në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

SC-BC-2020-05, Përmbledhje e Aktgjykimit, 16 dhjetor 2022, para. 6 - 7

II.

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykses çështjen gjyqësore të z. Pjetër Shala. Z. Shala, që pretendohet se ishte anëtar i UÇK-së i vendosur në Kukës, Shqipëri, u arrestua më 16 mars në Belgjikë dhe u transferua në DHSK më 15 prill 2021. Ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme), që pretendohet se u kryen midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, kundër personave të ndaluar në Fabrikën e Metalit në Kukës (Shqipëri) që pretendohet se shfrytëzohej nga UÇK-ja.

Në seancën e paraqitjes së parë në prill 2021, z. Shala u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

Kryetarja caktoi të njëjtin Trup Gjykses I, që gjykoj çështjen gjyqësore kundër z. Salih Mustafa. Trupi Gjykses përbëhet nga të njëjtët gjykatës: Mapi Feld-Folia (kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë).



Konferenca përgatitore për gjykim në çështjen e z. Pjetër Shala, 18 tetor 2022

Konferenca përgatitore për gjykimin u mbajt nga 18 deri më 20 tetor dhe pritet që palët të bëjnë deklaratat hyrëse gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka pranuar tetë viktima pjesëmarrëse.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se parashtruesit e kërkesave si anëtarë të familjes së ngushtë të viktimës së drejtpërdrejtë kanë pësuar personalisht dëm mendor (traumë psikologjike, stres, makthe, ankth dhe pikëllim) si pasojë e drejtpërdrejtë e ndalimit arbitrar të pretenduar, trajtimit mizor dhe torturës që pretendohet të ketë pësuar viktima e drejtpërdrejtë.


KSC-BC-2020-04/F00279/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 19 shtator 2022, para. 30.

III.

Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Aktakuza kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi ngre kundër tyre dhjetë akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të akuzuarit u arrestuan në Kosovë më 4 dhe 5 nëntor 2020 dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së po ato ditë.


Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve lëshoi një numër të madh vendimesh dhe urdhrash të ndryshëm, duke mundësuar kalimin e çështjes te trupi gjykues rreth fundit të vitit.



Konferenca për ecurinë e çështjes në çështjen gjyqësore kundër z. Thaçi dhe të tjerë, 8 shtator 2022

Konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore trupit gjykues më 15 dhjetor 2022 dhe Kryetarja caktoi Trupin Gjykues II, i përbërë nga gjykatësit Çarls Smith III (kryegjykatës), Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor (rezervë).

Ky është i njëjti trup gjykues që gjykoj çështjen gjyqësore kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj. Më 16 dhjetor 2022 u mbajt seanca e parë, gjatë së cilës u diskutuan çështje lidhur me administrimin e gjyqimit.



Seancë nga çështja gjyqësore Hashim Thaçi dhe të tjerë, 16 dhjetor 2022

Deri në fund të viti vitit 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi 53 persona si viktimë pjesëmarrëse në proces.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kjo pikë ka të bëjë në veçanti me të drejtën e z. Thaçi për të komunikuar privatisht me mbrojtësin e tij dhe për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 6(3)(b) dhe (c) i KEDNJ-së dhe neni 21(4)(c) dhe (e) i Ligjit). Nëse masat e incizimit dhe të nxjerrjes i shkelin këto të drejta, kryerja e drejtë e procesit do të cenohej ndjeshëm. Krahas kësaj, zgjidhja e kësaj pike në një fazë të hershme do ta thjeshtonte procesin dhe do të ndihmonte ushtrimin e së drejtës së të Akuzuarve për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme (neni 21(4)(d) i Ligjit).

KSC-BC-2020-06/F00939, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00854, 26 gusht 2022, para. 40.

PROCEDURAT PARA DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT



Gjykatësit e Dhomës së Apelit

I.

Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt

Çështja gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt është çështja e parë që kaloi në apel. Z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen për katër vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, për frikësim, për hakmarrje, dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan më 25 shtator 2020 dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020.

Shqiptimi i aktgjykimit nga Trupi Gjykes II më 18 maj 2022 shënoi një arritje të rëndësishme për DHSK-në.

Trupi Gjykses i shpalli fajtorë z. Gucati dhe z. Haradinaj për tri nga katër akuzat, për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Të dy të akuzuarit u dënuan me katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, si dhe me një gjobë prej 100 eurosh. Z. Gucati dhe z. Haradinaj u shpallën të pafajshëm lidhur me akuzën për hakmarrje.



Shqiptimi i aktgjykimit në çështjen gjyqësore Gucati dhe Haradinaj, 18 maj 2022

Trupi Gjykses e kreu gjykimin në mënyrë të shpejtë. Procesi u zhvillua gjatë 32 ditëve, nga 7 tetori 2021 deri më 3 shkurt 2022. Gjatë kësaj periudhe u thirrën 32 dëshmitarë dhe u pranuan gjithsej 238 prova materiale. Aktgjykimi u nxor në mënyrë efektive, vetëm dy muaj pas përfundimit të gjykit.

Z. Gucati dhe z. Haradinaj e apeluan aktgjykimin dhe Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit, të përbërë nga gjykatësit Mishelë Pikar (kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Konferenca para apelit u mbajt më 5 korrik 2022 dhe seanca e apelit u mbajt më 1 dhe 2 dhjetor 2022.



Konferenca para apelit në çështjen gjyqësore Gucati dhe Haradinaj, 5 korrik 2022

Kjo çështje është e rëndësishme, sepse pasqyron vetë arsyen pse u krijuan Dhomat e Specializuara. Kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore dhe, çka është më e rëndësishme, sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e tyre nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Pa dëshmitarë, nuk mund të ketë drejtësi për viktimat apo për shoqërinë në përgjithësi. Veprimet dhe sjellja e të akuzuarve sfiduan pikërisht këtë themel.

Përmbledhje e Aktgjyimit në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt (KSC-BC-2020-07), 18 maj 2022 f. 1.



Seanca e apelit në çështjen gjyqësore kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj, 2 dhjetor 2022

II. Apelet e Ndërmjetme

Me përparimin e ndjeshëm që u bë në të katër çështjet gjyqësore, në vitin 2022 Panelet e Gjykatës së Apelit u ngarkuan edhe me shqyrtimin e një numri të madh apelesh, të paraqitura nga shtatë prej tetë të akuzuarve në tri çështje gjyqësore. Panelet nxorën vendime për konfirmimin e vazhdimin të paraburgimit

të një numri të akuzuarish dhe trajtuan aspekte lidhur me pjesëmarrjen e viktimave, mangësi në formën e aktakuzës, ndryshime në listën e provave materiale, ligjshmërinë e Dhomave të Specializuara dhe ndryshime në aktakuzë.

Paneli rikujton se “duhet supozuar se një i akuzuar e përgatit mbrojtjen e vet në bazë të fakteve materiale që përmban aktakuza, jo në bazë të të gjithë materialit që i është bërë i ditur” [...] dhe [...] thekson se ka shumë rëndësi që të akuzuarve t’u jepen kohë dhe burime të mjaftueshme për t’i hetuar në mënyrën e duhur incidentet e reja.

KSC-BC-2020-06/IA018/F00007, Vendim mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Vendimit lidhur me Kërkesën për Ndryshimin e Aktakuzës sipas Rregullës 90(1)(b) të Rregullores, 22 mars 2022, para. 48.

Ndonëse Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se pjesëmarrja e viktimave në çështjen gjyqësore konkrete kufizohet në viktimat e krimeve të pretenduara në Aktakuzë, ai thekson gjithashtu se pjesëmarrja e viktimave anonime, në disa rrethana, mund të cenojë të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë. Për shembull, në rast se [viktima pjesëmarrëse në proces] thirret si dëshmitar, masa mbrojtëse në fuqi për [viktimën pjesëmarrëse në proces] mund të rivlerësohet [...].

KSC-BC-2020-06/IA023/F00006, Vendim mbi Apelin e Veselit kundër “Vendimit të Tretë për Pjesëmarrjen e Viktimave”, 15 shtator 2022, para. 49.

DHOMA E GJYKATËS SUPREME

Më 29 qershor 2022, z. Kadri Veseli dorëzoi një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të tij. Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme, të kryesuar prej saj në përputhje me nenin 32(1) të Ligjit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), me anëtarë gjykatësit Kristinë van den Vajngart dhe Mihael Bolander.

Më 15 gusht 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin në të cilin konstatoi se z. Veseli nuk kishte arritur të vërtetonte se ishin bërë shkelje thelbësore të procedurës së Ligjit dhe të Rregullores së Procedurës dhe të Provave. Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme e hodhi poshtë kërkesën e z. Veseli në tërësi. Kjo ishte hera e parë që Paneli i Gjykatës Supreme mori në shqyrtim një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Paneli është bindur se në Dhomat e Specializuara zbatohet një sistem rigoroz dhe se vendimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake ofroi garancitë e duhura për proces ligjor të rregullt. [...]

Paneli vëren se, në pamje të parë, koha prej gati katër muajsh që iu desh Panelit të Gjykatës së Apelit për të nxjerrë Vendimin e Kundërshtuar mund të mos konsiderohet si e shkurtër brenda kuptimit të nenit 41(2) të Ligjit. Megjithatë, pasi ka vlerësuar me kujdes të gjithë faktorët e përmendur më lart, Paneli gjykon se në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, koha që iu desh Panelit të Gjykatës së Apelit për nxjerrjen e Vendimit të Kundërshtuar është e përligjur dhe konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 41(2) të Ligjit.

KSC-BC-2020-06/PL001/F00008, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 15 gusht 2022, para. 40, 42.

DHOMA E SPECIALIZUAR E GJYKATËS KUSHTETUESE



Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Gjatë vitit 2022, DHSGJK-ja mori në shqyrtim pesë kërkesa referuese. Më 13 qershor, 6 korrik dhe 22 gusht, DHSGJK-ja lëshoi vendime mbi këto pesë kërkesa referuese të paraqitura nga z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Jakup Krasniqi dhe z. Pjetër Shala, në të cilat ata pretendonin shkelje të të drejtave të tyre themelore dhe kundërshtonin, ndër të tjera, ligjshmërinë e ngritjes së akuzës për ndërmarrje kriminale të përbashkët, juridiksionin e Dhomave të Specializuara, si dhe pretendonin shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë.

Paneli konstatoi se kërkesat referuese ishin të parakohshme dhe i shpalli të papranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Kosovës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Në vendimet e saj DHSGJK-ja konstatoi, ndër të tjera, se e drejta zakonore ndërkombëtare mund të zbatohet drejtpërdrejt në Dhomat të Specializuara.

Dhoma gjykon se, duke qenë se akuzat duhet të kenë lidhje me Raportin [e 7 janarit 2011 të Këshillit të Evropës], kjo lidhje duhet kuptuar se duhet marrë parasysh përmbajtja dhe konteksti i paraqitur në Raport dhe detyrimet ndërkombëtare të Kosovës që burojnë nga Raporti. Me fjalë të tjera, aktet e rënda që do të vlerësohen duhet të kenë lidhje me përmbajtjen dhe kontekstin e Raportit, i cili, ndër të tjera, paraqiti një tablo të përgjithshme shqetësuese të situatës në Kosovë, përfshirë mungesën e llogaridhënies për disa sjellje kriminale të rënda.

KSC-CC-2022-15/F00010, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe Paanshme të Themeluar me Ligj dhe të Drejtën për Mendim të Arsyetuar, 13 qershor 2022, para. 82.

Nga kjo rrjedh zbatimi i drejtpërdrejtë [nga Dhomat e Specializuara] i dispozitave për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, përfshirë format e përgjegjësisë penale sipas [së drejtës zakonore ndërkombëtare] për të vërtetuar fajësinë e një personi është në pajtim me Kushtetutën [...], me kusht që ky zbatim të jetë në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe nenin 7 të Konventës, sikurse interpretohet nga GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj.

KSC-CC-2022-16/F00004, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të Drejtat Themelore të tij të Garantuara nga neni 33 i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 6 korrik 2022, para. 69.

2 | Kryetarja dhe gjykatësit

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksione gjyqësore sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera për shkak se janë në Regjistër, por vetëm kur caktohen nga Kryetarja për të kryer funksionet zyrtare të tyre. Gjykatësit e emëruar, për aq sa është e mundur, i kryejnë funksionet gjyqësore të tyre nga distanca.

PLENARJA VJETORE

Më 11 mars, gjykatësit u mbledhën për plenaren e gjashtë, që u mbajt përmes videokonferencës për shkak të pandemisë së KOVID-19. Gjatë plenares, Kryetarja u dha gjykatësve informacion të përditësuar lidhur me aspekte institucionale aktuale.

Gjykatësit dëgjuan prezantime edhe nga Administratorja dhe nga shefat e njësive të Zyrës Administrative. Ata diskutuan gjithashtu çështje të rëndësishme për DHSK-në, ndër të cilat edhe për efikasitetin e proceseve gjyqësore.

MBLEDHJA E GJYKATËSVE

Më 16 maj, gjykatësit u mbledhën për herë të parë në selinë e Gjykatës që nga fillimi i pandemisë së KOVID-19. Gjykatësit, si dhe një numër të ftuarish nga gjykata dhe tribunalë ndërkombëtarë, u

mbledhën për të bërë përrurimin zyrtar të sallës së gjyqit. Kjo ishte edhe hera e parë që gjashtë gjykatësit e emëruar rishtas patën mundësinë të takoheshin personalisht me kolegët e tyre.



Kryetarja Trendafilova në ceremoni, 16 maj 2022

Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjustatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare
(Bullgari)



Gjustatës Çarls L. Smith III
Nënkryetar
(SHBA)



Gjustatës Vidar Stensland
Gjustatës Kushtetues
(Norvegji)



Gjustatës Antonio Balsamo
Gjustatës Kushtetues
(Itali)



Gjustatës Rumen Nenkov
Gjustatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjustatëse Romina Inkuti
Gjustatëse Kushtetuese Rezervë
(Itali)



Gjustatëse Kristinë van den
Vajngart
(Belgjikë)



Gjustatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjustatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjustatës Emilio Gati
(Itali)



Gjustatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjustatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjustatës Keneth Roberts
(Kanada)



Gjustatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)




Gjustatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjustatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjustatës Ginel Metro
(Zvicër)



Gjustatës Nikola Giju
(Francë)



Gjustatës Zhiber Biti
(Francë)



Gjustatës Daniel Fransens
(Belgjikë)



Gjustatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjustatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)

3 | Aktivitetet e jashtme

Gjatë vitit 2022, Kryetarja Trendafilova vazhdoi të informonte publikun dhe palët e interesuara për aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim, Kryetarja u takua me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE), të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuese, të shtetit pritës dhe të Kosovës.

Kryetarja vizitoi Kosovën nga 20 deri më 23 shtator 2022. Gjatë vizitës ajo zhvilloi edhe një aktivitet komunikues dhe ndërgjegjësues në internet për shoqërinë civile dhe median, si dhe u takua personalisht me studentë të drejtësisë. Ajo u takua edhe me Ministren e Drejtësisë së Kosovës dhe me anëtarë të bashkësisë ndërkombëtare, ndër të cilët ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese në Kosovë, me shefin e zyrës së BE-së dhe përfaqësuesin e BE-së për Kosovën, dhe me shefin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).



Kryetarja Trendafilova në një aktivitet për komunikim dhe ndërgjegjësim në Kosovë, 21 shtator 2022



Kryetarja Trendafilova takohet me studentë të drejtësisë në Prishtinë, Kosovë, 21 shtator 2022

Kryetarja u paraqit personalisht para Komitetit Politik dhe të Sigurisë së BE-së më 27 tetor në Bruksel. Në këtë paraqitje ajo i informoi shtetet anëtare për aktivitetet gjyqësore të DHSK-së dhe iu përgjigj pyetjeve të përfaqësuesve të shteteve anëtare të BE-së.

Për të forcuar më tej marrëdhëniet e DHSK-së me aktorë të tjerë të jashtëm dhe me shoqërinë civile, Kryetarja zhvilloi takime (kryesisht përmes videokonferencave) me përfaqësues të komuniteteve diplomatike, juridike dhe akademike. Kryetarja gjithashtu dha intervista për mediat, në të cilat diskutoi për mandatin dhe punën e DHSK-së.

Si Kryetare e DHSK-së, jam e përkushtuar që të komunikoj me njerëzit dhe të dëgjoj mendimet e tyre. Dëshiroj që njerëzit ta dinë se DHSK-ja është një gjykatë e pavarur që mundëson gjykime të drejta dhe ku të drejtat e të akuzuarve respektohen, dëshmitarët mbrohen dhe viktimat trajtohen me dinjitet.

Intervista e Kryetares Trendafilova me Danas, 27 qershor 2022.



Gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Marrëdhëniet me jashtë



Marrëdhëniet me jashtë

Me përshpejtimin e ritmit të punës në proceset gjyqësore, Kryetarja dhe Administratorja vazhduan rolin e tyre të rëndësishëm për t'i shpjeguar publikut në Kosovë dhe rajon se si punon Gjykata për të mundësuar procese gjyqësore të drejta, sigurta dhe efektive në përputhje me standardet më të larta të drejtësisë penale ndërkombëtare.

Më 31 janar, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar pritën në Gjykatë Komisioneren për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, znj. Dunja Mijatović.

Më 21 shkurt, drejtuesit e lartë pritën në Gjykatë një delegacion nga Shërbimi i BE-së për Instrumentet e Politikës së Jashtme.

Më 22 mars, drejtuesit e lartë zhvilluan një takim me ambasadorë të shteteve anëtare të BE-së, me ftesë të ambasadorit të Republikës së Francës, gjatë të cilit dhanë shkurtimisht informacion për statusin e proceseve gjyqësore.

Më 1 prill, Kryetarja dhe Administratorja pritën në mjediset e DHSK-së Ministren e Drejtësisë së Kosovës, SH. e S. Albulena Haxhiu. Gjatë takimit u diskutuan çështje lidhur me sistemin e ndihmës juridike të DHSK-së, mundësimin e vizitave familjare për të paraburgosurit, dhe çështje të tjera në kuadër të kornizës ligjore të DHSK-së.

Nga 23 deri më 24 qershor, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar pritën përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së të Komitetit për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave. Drejtuesit e lartë informuan për zhvillimet e fundit dhe iu përgjigjën pyetjeve. Të ftuarit dëgjuan gjithashtu prezantime nga shefat e njësisë të DHSK-së.

Më 17 tetor, SH e T. Tomash Sunjog (Tomáš Szunyog), shefi i Zyrës së BE-së dhe përfaqësuesi special i BE-së për Kosovën, vizitoi DHSK-në për t'u takuar me drejtuesit e lartë.

Më 18 tetor, drejtuesit e lartë u takuan me anëtarë të Rrjetit të Informimit të Gjykatës (RRIGJ), ku dhanë një përmbledhje të shkurtër të punës që po bëhej në Gjykatë dhe dëgjuan mendimet e anëtarëve të RRIGJ-së për aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimin të DHSK-së.

Kryetarja, e shoqëruar nga Administratorja, u paraqit personalisht edhe para Komitetit të BE-së për Politikë dhe Siguri më 27 tetor në Bruksel. Ajo i informoi shkurtimisht shtetet anëtare për aktivitetet gjyqësore të DHSK-së dhe iu përgjigj pyetjeve që iu bënë.


Më 24 nëntor, gjatë takimit informues vjetor, Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar informuan përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese me seli në Hagë për punën e DHSK-së dhe ZPS-së.



Më 2 dhjetor, Kryetarja, Administratorja dhe Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar pritën në Gjykatë komandantin e BE-së për Operacione Civile, Stefano Tomat.

Kryetarja dhe Administratorja gjithashtu u takuan me përfaqësues të autoriteteve diplomatike, ndërkombëtare dhe kombëtare, përfshirë ambasadorin e SHB-së për Drejtësi Penale Globale, SH. e S. Beth Van Shak (Beth Van Schaack), një delegacion gjykatësish nga Franca, një delegacion gjykatësish nga Gjykata Penale Speciale për Republikën e Afrikës Qendrore dhe një delegacion gjykatësish nga Republika Federale e Gjermanisë.

Në vitin 2022, Kryetarja dha gjashtë intervista për mediat në Kosovë dhe rajon dhe botoi një artikull në mediat kosovare lidhur me procesin e apelit në DHSK, në shqipe dhe serbishte.



Pavarësia dhe paanësia gjyqësore janë pjesë përbërëse e profesionit të gjykatësve dhe garantojnë që drejtësia të jepet në përputhje me parimin e sundimit të ligjit. Para marrjes së detyrës, gjykatësit e DHSK-së bëjnë një betim solemn se do t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të ndërgjegjshme. Ky betim është parim udhërrëfyes kur bëhet fjalë për të gjithë punën tonë në DHSK.

Pavarësia dhe paanësia nuk janë të vetmet garanci që sigurojnë të drejtat e palëve dhe pjesëmarrësve para DHSK-së. Një garanci tjetër e tillë është e drejta e të akuzuarve dhe/ose e Prokurorisë për të apeluar vendimet e një gjykatësi apo të një trupi gjyqësor para gjykatësve të tjerë të pavarur. Procesi i apelit ofron një nivel shtesë të rishikimit të aktgjyqimeve të shpallura nga gjykatat e shkallës më të ulët. Ai krijon mundësinë, në qoftë se është e zbatueshme, për të korrigjuar çdo gabim faktik ose juridik në aktgjyqimet e shpallura nga gjykatat e shkallës më të ulët.

Kryetare Trendafilova, artikull lidhur me procesin e apeleve në DHSK, botuar në "Telegrafi" (shqip) dhe "Kossev" (serbisht), 25 dhe 26 gusht 2022


VEPRIMTARITË KRYESORE TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA 2022



VAZHDUAN GJYKIMET
NË **4 ÇËSHTJE GJYQËSORE** ME
8 TË AKUZUAR



AKTGJYKIME
NË **2 ÇËSHTJE**



U MBAJTËN **65 SEANCA PUBLIKE** QË
U TRANSMETUAN NË INTERNET
NË **3 GJUHËT** E GJYKATËS



+ 42.000 SHIKIME TË
FAQEVE ME TRANSMETIME



DËSHMUAN **22 DËSHMITARË**
DHE **1 VIKTIMË**



PANELET NXORËN RRETH
660 VENDIME DHE URDHRA



U PËRKTHYEN **1.054 DOKUMENTE** ME
MBI **15.800 FAQE** MË 2022



U PRANUAN **40 VIKTIMA**
PJESËMARRJE NË PROCES
NË TRI PREJ ÇËSHTJEVE



MË SE 600 PERSONA NË KOSOVË MORËN
PJESË NË AKTIVITETE INFORMIMI
PUBLIK PËR GJYKATËN

Zyra Administrative



Zyra Administrative

Zyra Administrative ofron shërbime administrative për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ajo ofron gjithashtu shërbime mbështetëse gjyqësore në mënyrë të paanshme dhe të pavarur. Zyra Administrative drejtohet nga Administratorja e cila këshillohet me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar lidhur me çështje institucionale.

Funksionet e Zyrës Administrative përfshijnë sigurinë, prokurimin, burimet njerëzore, buxhetin dhe financimin dhe teknologjinë e informacionit. Shërbimi i mbështetjes gjyqësore përfshinë mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, si dhe shërbimet e përkthimit me shkrim dhe gojë, administrimin e Gjykatës dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Gjatë gjithë vitit 2022, nën udhëheqjen e Administratores, të gjithë punonjësit e Zyrës Administrative u fokusuan në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për administrimin e suksesshëm të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe për mbështetjen e proceseve gjyqësore në Gjykatë. Zyra Administrative gjithashtu mundësoi, brenda një kohe të shkurtër, pesë vizita të të paraburgosurve në Kosovë për arsye humanitare, në përputhje me urdhrat e paneleve përkatës. Krahas kësaj, kontaktet me Rrjetin e Informimit të Gjykatës dhe komunitetet në Kosovë u përforcuan me kthimin në Kosovë të ekipit për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Administratore e DHSK-së është dr. Fidelma Donlon. Në cilësinë e saj si Administratore, ajo nënshkruan në emër të DHSK-së dhe ZPS-së marrëveshjen për subvencionim me Bashkimin Evropian (BE), që është burimi kryesor i financimit të Gjykatës. Në shkurt të këtij viti u nënshkrua edhe marrëveshja e tretë për subvencionim me qeverinë zvicerane për vazhdimin e mbështetjes së aktiviteteve komunikuese dhe ndërgjegjësuere në Kosovë.



Administratorja Fidelma Donlon

Administratorja siguron miradministrimin financiar të buxhetit dhe mbikëqyr proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Për optimizimin e burimeve njerëzore të disponueshme në DHSK dhe ZPS, Administratorja, në bashkëpunim me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar, mori vendime lidhur me ricaktimin e punonjësve për t'iu përgjigjur ndryshimeve të nevojave të punës në Gjykatë. Krahas kësaj, në vitin 2022, drejtuesit përfunduan vlerësimin e plotë të veprimtarive dhe rishikimin e të gjitha posteve të punës, për të përcaktuar nëse ka kapacitete të mjaftueshme për të siguruar administrim të shpejtë të të gjitha gjykimeve të ardhshme.

Pas kësaj, Administratorja negocioi me shtetet anëtare të BE-së lidhur me një numër të kufizuar postesh shtesë për arritjen e këtij qëllimi.


Këtë vit u bë përparim i konsiderueshëm në dy prioritete strategjike të caktuara nga Administratorja në vitin 2021, në lidhje me administrimin e dokumentacionit dhe të provave materiale. U ndërmoren hapat e parë për krijimin e arkivit të Gjykatës dhe u përfundua analiza e gjithë dokumentacionit administrativ dhe gjyqësor me qëllim krijimin e Regjistrit të Aseteve të Informacionit dhe të Afateve të Ruajtjes së Informacionit. Krahas kësaj, pas marrjes së mendimeve të mbi 200 përdoruesve të sistemit elektronik të administrimit të Gjykatës gjatë dy gjykimeve të para, ky sistem u përmirësua për të shtuar kapacitetin e përpunimit të vëllimit të madh të dokumenteve të nxjerra për palët dhe të parashtrimeve të protokolluara që administrohen në Gjykatë. Këtë vit, u analizuan dhe u kategorizuan me sukses 20 terabajt (terabytes) informacion në Regjistrin e Aseteve të Informacionit, dhe u përpiluan Afatet e Ruajtjes së Informacionit

për miratim nga Administratorja. Sistemi elektronik për administrimin e Gjykatës u përmirësua përmes fuqizimit të funksionit të kërkimit dhe të funksionit për përcaktimin e versionit të fundit të dokumenteve.

Angazhimi konstruktiv i Zyrës Administrative me autoritetet e shtetit pritës vazhdoi edhe në vitin 2022. Këtu u përfshinë diskutimet për mirëmbajtjen e ndërtesave dhe të zyrave të DHSK-së dhe ZPS-së, në kuadër të të cilave u lidh edhe një marrëveshje e re për nivelin e shërbimeve. Administratorja u përqendrua edhe në lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit me shtetet në fushat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të kryerjes së dënimit me burgim. Në maj 2022, pas shqiptimit të aktgjykimit në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* dhe miratimit të Udhëzuesit të Punës për Caktimin e Shtetit të Kryerjes së Dënimit, Administratorja kreu takime të shumta dypalëshe me shtetet, ku u diskutua gatishmëria e tyre për t'i pranuar personat e dënuar nga DHSK-ja që të kryejnë dënimet me burgim në ato shtete.







1 | Kabineti i Administratores

Administratorja ka një ekip të posaçëm, Kabinetin e Administratores (KA), që e mbështet në përbushjen e përgjegjësive të saj. Ky ekip kryen detyra me karakter ligjor dhe joligjor që lidhen me proceset gjyqësore dhe administrimin e Gjykatës, marrëdhëniet me shtetin pritës dhe ato diplomatike, marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit, bashkërendimin e raportimit në BE, si dhe shërbimet protokollare. Në përgjegjësitë e KA-së përfshihet gjithashtu edhe Njësia e Administrimit të Informacionit (AdmInfo).

Më 2022, ekipi juridik i Kabinetit të Administratores ofroi këshilla për një sërë çështjesh ligjore të brendshme dhe të jashtme, ndër të tjera lidhur me interpretimin dhe zbatimin e instrumenteve të ndryshme ligjore, aspekte të përputhshmërisë ligjore dhe të kontratave, mbrojtjen e të dhënave personale dhe bashkëpunimin e jashtëm. Ekipi bashkëpunoi për hartimin dhe përpiloi disa rregullore të brendshme, ku vlen të përmendet strategjia kundër ngacimit dhe korniza për mbajtjen dhe arkivimin e dokumenteve në DHSK. Ekipi gjithashtu ofroi mbështetje ligjore lidhur me ndryshimet në Rregulloren për Punonjësit dhe administroi shqyrtimin dhe përgatitjen e 195 parashtrimeve të Administratores në proceset gjyqësore para DHSK-së, për tema si mbrojtja e dëshmitarëve, pjesëmarrja e viktimave, përgatitja e gjykimit, paraburgimi dhe vizitat e të paraburgosurve në Kosovë.

Po kështu, në vitin 2022, Kabineti i Administratores mbështeti Administratoren edhe në lidhje me kontaktet e saj diplomatike, veçanërisht për sa i përket arritjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtetet në fushat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të kryerjes së dënimeve. Gjithashtu ai ndihmoi edhe në administrimin e një numri kërkesash për bashkëpunim dhe ndihmë.

Mbështetja në fushën e protokollit vazhdoi të përqendrohej në mundësimin e hyrjes së anëtarëve të familjeve të të paraburgosurve në Holandë.

Njësia e Administrimit të Informacionit ofron këshilla dhe mbështetje për administrimin e sigurt të informacionit, dokumentacionit dhe arkivave të DHSK-së. Në vitin 2022, në kuadër të prioriteteve strategjike të Administratores në fushën e administrimit të dokumentacionit dhe arkivave, punonjësit e Njesisë së Administrimit të Informacionit kryen një analizë të gjerë të të gjithë dokumentacionit administrativ dhe gjyqësor të DHSK-së, si hapi i parë për ruajtjen dhe trajtimin e mëtejshëm efikas të dokumentacionit. U analizuan dhe kategorizuan me sukses 20 terabajt informacion në Regjistrin e Aseteve të Informacionit. Informacioni i dhënë u përdor gjithashtu për krijimin e Afateve për Ruajtjen e Informacionit. Gjithashtu Kabineti i Administratores punoi edhe për përgatitjen e udhëzuesve mbi administrimin dhe përdorimin e sigurt të arkivit të DHSK-së, në kuadër të konsultimeve të brendshme dhe miratimit të tyre në të ardhmen.

Krahas kësaj, Njësia e Administrimit të Informacionit mundësoi kurse për rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve të DHSK-së lidhur me sigurinë kibernetike dhe të informacionit, përfshirë edhe përmes përdorimit të platformës për trajnime mbi sigurinë e informacionit që ofron Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian (EEAS). Njësia e Administrimit të Informacionit ofroi gjithashtu shërbime bibliotekare dhe mbështetje për hulumtimet e shumë palëve, si dhe iu përgjigj mbi 120 kërkesave për libra, artikuj dhe materiale të tjera nga koleksioni i brendshëm, ose përmes bashkëpunimit tashmë të konsoliduar me Bibliotekën e Pallatit të Paqes dhe rrjetin institucional të saj.

2 | Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Në vitin 2022 në DHSK pati një numër zhvillimesh gjyqësore të rëndësishme. Shqiptimi i dy aktgjykimeve si dhe pritja e aktgjykimit të Panelit të Gjykatës së Apelit ngjallën një interes të konsiderueshëm të publikut për aktivitetet e Gjykatës. Këto arritje gjyqësore u shoqëruan edhe me rritjen e punës komunikuese dhe ndërgjegjësuese të DHSK-së, për t'ia bërë më të lehtë publikut marrjen e informacionit për këto zhvillime – ndonjëherë të ndërlikuara – gjyqësore.

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP) përdor kanale të ndryshme komunikimi për të ofruar informacion të hollësishëm dhe të saktë lidhur me Gjykatën dhe aktivitetet e saj. Me anë të intervistave me mediat, takimeve me shoqërinë civile, dhe materialeve informuese të shtypura ose digjitale, NJIKP-ja punon për t'ia bërë proceset e Gjykatës të kuptueshme për publikun dhe për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me mandatin e Gjykatës.

Pas lehtësimit të kufizimeve në kuadër të pandemisë KOVID-19, DHSK-ja iu rikthye aktiviteteve të rregullta të komunikimit dhe ndërgjegjësimit me

praninë fizike të pjesëmarrësve. Gjatë vitit 2022, Gjykata i shtoi përpjekjet për t'i sjellë proceset gjyqësore të zhvendosura më afër publikut të gjerë në Kosovë, përmes takimeve me grupe të ndryshme anembanë Kosovës për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të marrë mendimet dhe opinionet e tyre, si dhe për t'u shpjeguar se çfarë po ndodhte në sallën e gjyqit. Disa nga pyetjet më të shpeshta që u bënë në këto aktivitete shërbyen si tema për katër videomateriale të reja informuese që u krijuan në vitin 2022, për t'u transmetuar në televizionet e Kosovës gjatë vitit 2023.

Për t'u ardhur në ndihmë gazetarëve për të raportuar mbi proceset gjyqësore, NJIKP-ja mbajti informime javore për mediat përmes internetit, gjatë të cilave zëdhënësit e DHSK-së ofruan informacion të përditësuar për zhvillimet e javës dhe morën pyetje të gazetarëve, të cilët mund të merrnin pjesë në këto përditësime nga Kosova, rajoni dhe gjetkë. Më 2022, DHSK-ja botoi një fletinformacion "Një vështrim i shkurtër mbi DHSK-në" me informacione mbi krijimin dhe strukturën e Gjykatës, si dhe për çështjet gjyqësore që po zhvillohen, në një format dhe gjuhë lehtësisht të kuptueshme.



Zëdhënësjja Angela Griep në një informim javor për mediat përmes internetit, ku informon për proceset gjyqësore

2.1 | Marrëdhëniet me mediat

Gjatë gjithë vitit pati interesim në rritje të mediave për proceset e DHSK-së, veçanërisht në Kosovë dhe në rajon. Krahas fushave të tjera me interes për mediat, pyetjet e tyre shpesh kishin të bënin me hollësi specifike ose aspekte të ngritura në parashtrimet gjyqësore, komentet e bëra nga palët gjatë seancave publike dhe vendimet për vazhdimin e paraburgimit. DHSK-ja vazhdoi takimet e rregullta me gazetarë në Kosovë për t'u dhënë atyre informacion për Gjykatën, me qëllim që të bëheshin raportime të sakta mbi proceset gjyqësore. Një ndër këto takime ishte edhe ai me kryeredaktorët e mediave kryesore në Kosovë.


Më 2022, DHSK-ja iu përgjigj 250 pyetjeve të mediave dhe, sa herë që ishte e mundur, dha

intervista në televizion dhe radio. Kryetarja dhe Administratorja vazhduan angazhimet e tyre me mediat këtë vit; Kryetarja dha gjashtë intervista dhe botoi një artikull në dy media të Kosovës.

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2022, me heqjen e të gjitha kufizimeve të COVID-19, gazetarëve dhe publikut iu krijua mundësia t'i ndiqnin proceset drejtpërdrejt nga galeria për publikun, pa pasur nevojë për regjistrim paraprak. Gazetarët patën mundësinë t'i ndiqnin po ashtu proceset nga qendra për mediat, nga ku seancat mund të incizohen. Përmes funksionit të transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së, mediave dhe publikut iu krijua gjithashtu mundësia që seancat t'i ndiqnin lehtësisht përmes internetit nga kudo në botë.



Kryetarja Trendafilova në një intervistë me Kosova Press, shtator 2022



Vizita të publikut në DHSK gjatë Ditës së Vizitave në Hagë, tetor 2022



Aktivitet për komunikim dhe ndërgjegjësim në Bostan, Kosovë, mars 2022



Aktivitet për komunikim dhe ndërgjegjësim në Pejë, Kosovë, mars 2022



Aktivitet për komunikim dhe ndërgjegjësim në Uglarë, Kosovë, shtator 2022



Dita e Vizitave në Hagë, tetor 2022

2.2 | Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

DHSK-ja ka mandat që të kryejë procese gjyqësore të drejta, të paanshme, të pavarura, të sigurta dhe të mbrojtura. DHSK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë vazhdimet të dialogut me shoqërinë civile përmes një programi solid për komunikim dhe ndërgjegjësim, për të siguruar që publiku në Kosovë dhe në rajon të mund të përcjellë dhe kuptojë zhvillimet në Hagë.

Përmes aktiviteteve të rregullta me të rinj, studentë, avokatë, gazetarë, udhëheqës të komuniteteve dhe persona të tjerë në Kosovë, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i angazhon pjesëmarrësit në shkëmbime të gjalla dhe ndërvepruese për punën e Gjykatës. Që nga viti 2018, janë mbajtur 133 aktivitete të tilla në të gjithë Kosovën. Më 2022, u mbajtën 24 takime për komunikim dhe ndërgjegjësim me komunitete të ndryshme në gjithë Kosovën: në Uglarë, Janjevë, Prizren, Gjilan, Ranillug, Pasjan, Letnicë, Kamenicë, Obiliq, Graçanicë, Novobërdë, Bostan, Shillovë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë, Pejë, Shtërpçë, Partesh. Dhjetë nga këto takime u zhvilluan përmes internetit.

Takimet informuese dhe ndërgjegjësuere u përshtaten interesave të pjesëmarrësve përkatës, jo vetëm duke u ofruar atyre informacion të përgjithshëm për mandatin dhe gjykimet, por edhe duke diskutuar me ta zhvillimet më të fundit në çështjet gjyqësore. Çka është më me rëndësi, këto takime i mundësojnë ekipit për komunikim dhe ndërgjegjësim që t'u përgjigjet drejtpërdrejt pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga pjesëmarrësit.

Për të mundësuar pjesëmarrje dhe ndikim sa më të gjerë të aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim, ekipi realizon materiale filmike të cilat i shfaq në YouTube dhe në faqen e internetit të DHSK-së, dhe të cilat transmetohen në Kosovë në gjuhët shqipe dhe serbe. Më 2022, NJIKP-ja realizoi një sërë videosh të reja mbi "Pyetjet më të shpeshta", me pyetjet më të shpeshta të bëra nga pjesëmarrësit në takime. Me shtimin e këtyre katër videomaterialeve të reja, DHSK-jatashmë ka një fond me 16 materiale filmike

informuese, 10 nga të cilat janë transmetuar 809 herë në televizionet në Kosovë dhe 12 gjenden në faqen e internetit të DHSK-së dhe kanalin e saj në YouTube, ku u shikuan me mijëra herë deri në fund të vitit 2022.

Edhe Kryetarja e DHSK-së u angazhua fuqimisht në aktivitetet për komunikim dhe ndërgjegjësim gjatë këtij viti, duke mbajtur dy takime në internet me përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile në Kosovë. Në këto takime ajo dha informacion të përditësuar lidhur me statusin e proceseve dhe iu përgjigj pyetjeve të pjesëmarrësve dhe gazetarëve. Në shtator 2022 Kryetarja gjithashtu udhëtoi në Kosovë, ku u takua me anëtarë të shoqërisë civile dhe studentë të fakultetit të drejtësisë në Prishtinë, me të cilët diskutoi mandatin dhe kornizën ligjore të Gjykatës dhe aspekte të punës së përditshme të DHSK-së.

Më 2022, Zvicra miratoi mbështetjen financiare për programin për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së edhe për dy vite të tjera, me anë të një subvencioni të ri. Mbështetja zemërgjerë e Zvicrës që nga janari 2018, i ka mundësuar DHSK-së që të forcojë më tej angazhimin e saj me publikun, paralelisht me zhvillimet e proceseve gjyqësore.



Aktivitet informues dhe ndërgjegjësuere në Kosovë, dhjetor 2022

2.3 | Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjeti i Informimit të Gjykatës

DHSK-ja bashkëpunon me shoqërinë civile në përpjekje për ta informuar publikun për aktivitetet e Gjykatës dhe për t'u përfshirë në dialog me ata që ndikohen më së shumti nga puna e saj. Që nga viti 2018, Gjykata është këshilluar rregullisht me OJQ-të anëtare të Rrjetit të Informimit të Gjykatës (RRIGJ) për të marrë mendimet e tyre për programin për komunikim dhe ndërgjegjësim, si dhe për materialet informuese dhe prezantimet. Rekomandimet e shoqërisë civile kanë qenë shumë të vyera për përpilimin e një programi që i përshtatet nevojave të njerëzve në Kosovë dhe rajon.

Në tetor 2022, Gjykata priti përfaqësues të OJQ-ve të RRIGJ-së për një punëtori në Hagë. Kryetarja dhe Administratorja u uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve të RRIGJ-së në DHSK dhe diskutuan me ta për mënyrat se si t'i sjellin më afër publikut proceset gjyqësore të DHSK-së. Përfaqësuesve të OJQ-ve u foli gjithashtu edhe Prokurori i Specializuar, i cili e informoi grupin mbi aktivitetet e ZPS-së në proceset publike.

Gjatë diskutimeve në grupe më të vogla, OJQ-të trajtuan aspekte të ndryshme të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim për të gjetur mënyra të reja për përhapjen e informacionit për Gjykatën në një audiencë sa më të gjerë në Kosovë dhe rajon.

2.4 | DHSK-ja në internet

Për ata që dëshirojnë të mësojnë më tepër për DHSK-në, faqja e internetit ofron informacion shumë të pasur në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Të gjitha seancat publike transmetohen drejtpërdrejt në të tri gjuhët e Gjykatës dhe parashtrimet e palëve, vendimet, urdhrat dhe aktgjykimet mund të gjenden në arkivin e dokumentacionit publik të Gjykatës në internet. Në rubrikën e përditësimeve në kohë reale ofrohet informacion mbi zhvillimet më të fundit në procese dhe lajme të tjera të rëndësishme lidhur me DHSK-në, ndërsa rubrika e çështjeve gjyqësore përmban informacion të përmbledhur për secilën çështje, si dhe lidhje me dokumente, transkripte dhe incizime të seancave përkatëse në *YouTube*.

Faqja e internetit gjithashtu u ofron mediave dhe publikut informacione të tjera për Gjykatën, si dhe lidhje me videomateriale informuese dhe infografikë, informacion për programin e pjesëmarrjes si viktimë, raporte të Avokatit të Popullit të DHSK-së, etj.

Gjatë vitit 2022, në faqen e internetit të DHSK-së u transmetuan 65 seanca publike, me përkthim të drejtpërdrejtë në shqipe, serbishte dhe anglishte. Faqet e transmetimit ishin më të vizituara në faqen e internetit të DHSK-së gjatë vitit, me më shumë se 42.000 shikime. Ndonëse ky numër është më i vogël se në vitin 2021, ka pasur rritje në shikimin e seancave publike në kanalin e DHSK-së në *YouTube*, nga ku ato mund të shihen në çdo kohë. Në tërësi, numri i vizitave në faqen e internetit të DHSK-së u rrit me 10%, duke arritur në 718.000 shikime më 2022.

Kanali i DHSK-së në *YouTube* u shikua më shumë se 30.000 herë, që është pothuaj trefishi i shikimeve në vitin 2021. "Mandati i Dhomave të Specializuara të Kosovës" – një video e shkurtër informuese, ishte më e shikuara, me më shumë se 1.100 shikime.

3 | Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) është i pavarur në monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, pasi ofron një mekanizëm më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

Avokati i Popullit i DHSK-së është Pietro Spera, gjykatës italian, i cili u emërua në këtë post në maj 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit të DHSK-së përshkruhen hollësisht në nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave të DHSK-së (Rregullorja) dhe në Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Në vitin 2022, Zyrës së Avokatit të Popullit iu paraqitën tri ankesa. Për dy prej këtyre ankesave procesi i shqyrtimit ka përfunduar ndërsa njëra është ende në proces shqyrtimi.

Një nga këto ankesa u hodh poshtë nga Avokati i Popullit për arsyen se ankuesi nuk argumentoi ose vërtetoi se DHSK-ja ose ZPS-ja ishin përfshirë në ndonjë mënyrë në çështjen për të cilën u paraqit ankesa. Procesi i shqyrtimit në lidhje me ankesën e dytë u ndërpre sepse ankesa ishte jo e plotë dhe, edhe pas kërkesës së Avokatit të Popullit, ankuesi nuk dha informacion shtesë dhe nuk e ndoqi çështjen më tej. Në të dy rastet, ankuesit u njoftuan për rezultatin e ankesave të tyre dhe iu dha arsytimi i plotë i vendimit të Avokatit të Popullit.

Që nga emërimi i tij, Avokati i Popullit ka marrë gjithsej 22 ankesa dhe për 20 prej tyre ka përfunduar procesin e shqyrtimit.

Në shtator 2022, Avokati i Popullit përfundoi hetimin administrativ në lidhje me një ankesë të paraqitur në vitin 2021. Ankuesi, një ish-punonjës i ZPS-së, pretendoi se bërja e ditur e emrit të tij në seancë të hapur dhe për Mbrojtjen kishte sjellë për pasojë shkeljen nga ZPS-ja të së drejtës së tij për jetë private dhe profesionale, të së drejtës së tij për jetë dhe së drejtës për jetë të familjes së tij.

Avokati i Popullit e deklaroi të papranueshme pikën e



Avokati i Popullit Pietro Spera

parë të ankesës dhe konstatoi se ZPS-ja, duke ia bërë të ditur Mbrojtjes emrin e ankuesit, nuk kishte shkelur të drejtat themelore të tij, pasi kjo ishte bërë mbi bazën e konfidencialitetit. Versioni i redaktuar i raportit përfundimtar në lidhje me këtë ankesë gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Në vitin 2022, Avokati i Popullit publikoi në faqen e internetit të DHSK-së përmbledhje të të gjitha ankesave të marra. Krahas përmbledhjeve, Avokati i Popullit publikoi të plota edhe konstatimet e tij në lidhje me të gjitha ankesat e marra që kishin të bënin me DHSK-në ose me ZPS-në.

Në kuadër të funksionit të tij monitorues, Avokati i Popullit vazhdoi gjatë gjithë vitit angazhimin e tij konstruktiv me DHSK-në dhe ZPS-në, me qëllim sigurimin e respektimit të përpiktë të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Në veçanti, Avokati i Popullit bashkëpunoi me Zyrën Administrative dhe Njësinë e Paraburgimit në lidhje me objektin e paraburgimit.

Gjatë vitit 2022, Avokati i Popullit kreu dy inspektime fizike të objektit të paraburgimit të DHSK-së, për të siguruar që ai funksiononte në përputhje të plotë me të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare dhe me standardet e pranuar të trajtimit. Këto inspektime u kryen në prill dhe tetor.

Gjatë këtyre inspektimeve, Avokati i Popullit pati

kontakte me të paraburgosurit dhe një sërë takimesh private me ta. Këto takime u krijojnë të paraburgosurve mundësinë që të paraqesin të gjitha vështirësitë me të cilat mund të përballen në lidhje me kushtet e paraburgimit. Pas çdo inspektimi, Avokati i Popullit i ka dorëzuar një raport Kryetares dhe Administratores.

Gjatë gjithë vitit 2022, Zyra e Avokatit të Popullit vazhdoi punën në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim. Më ndihmën e Njësisë për Informim dhe Komunikim të Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në një numër aktiviteteve ndërgjegjësuese me shoqërinë civile në rajon, që u zhvilluan me praninë fizike të pjesëmarrësve.

Në prill 2022, Avokati i Popullit kreu një takim kortezie me ministren e Drejtësisë së Kosovës dhe me një delegacion të Kuvendit të Kosovës.



4 | Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore ofroi mbështetje juridike dhe operative për Gjykatën dhe palët në proceset gjyqësore përmes njësive dhe zyrave të tij, të cilat janë: Njësia për Administrimin e Gjykatës, Njësia e Përkthimit, Zyra e Mbrojtjes, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njësia e Paraburgimit.

Në vitin 2022, DHSK-ja shënoi arritje madhore me shqiptimin e dy aktgjykimeve të para dhe kalimin e dy çështjeve gjyqësore trupave gjykues.

Dy çështje gjyqësore të tjera iu kaluan trupave gjykues. Gjatë vitit, njësi të ndryshme ndihmuan në përgatitjet lidhur me seancat, ofruan shërbime përkthimi, shërbime sigurie për dëshmitarët, përfaqësim të viktimave pjesëmarrëse në proces, si dhe garantuan kushte të sigurta paraburgimi për tetë të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

4.1 | Njësia për Administrimin e Gjykatës

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) është përgjegjëse për përpunimin dhe shpërndarjen e të gjithë dokumentacionit të çështjeve gjyqësore përmes sistemit elektronik *Legal Workflow* të administrimit të Gjykatës në DHSK dhe ka disa përgjegjësi në lidhje me administrimin e seancave gjyqësore, ndër të cilat edhe transkriptimi i seancave përmes sistemit elektronik *Transcend*. NJAGJ-ja administron gjithashtu edhe një arkiv fizik të posaçëm.

Në vitin 2022 u mbajtën 71 seanca gjyqësore. NJAGJ-ja përpunoi dhe shpërndau 327 transkripte të këtyre seancave në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës. Nga këto, 190 ishin publike dhe gjenden në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit të DHSK-së.

Gjatë vitit 2022, NJAGJ-ja mori, përpunoi dhe shpërndau 1.928 parashtrime dhe 1.428 shtojca të tyre, me afërsisht 100.000 faqe gjithsej. Në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik u përfshinë 918 parashtrime dhe shtojca të klasifikuara si publike.

Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave përkatës nga trupat gjykues për riklasifikimin e 108 parashtrimeve si publike, ato u ripërpunuan dhe rishpërndanë si të tilla. Përmes sistemit u përpunuan 5.072 kërkesa për përkthim dhe u dorëzuan mbi 200.000 materiale me palëve.

Vazhdoi puna për përmirësimin e sistemit *Legal Workflow*, për t'u ofruar palëve mjetet e nevojshme teknologjike për përmbushjen e nevojave të tyre si dhe për të përmirësuar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit, duke pasur parasysh përdorimin në rritje të tij. Deri në fund të vitit 2022, sistemi kishte gjithsej 348 përdorues, nga të cilët 110 përdorues të rinj, të cilëve iu ofruan trajnime fillestare dhe të përparuara për përdorimin e *Legal Workflow*. Gjithashtu, Njësia mbështeti 232 përdorues të programit kompjuterik të transkriptimit *Transcend*, që mundëson leximin në kohë reale të tekstit të plotë të seancave gjyqësore.

4.2 | Njësia e Përkthimit

Njësia e Përkthimit (NJP) ofron shërbime përkthimi me gojë dhe me shkrim, si në selinë e DHSK-së në Hagë, ashtu edhe gjatë misioneve.

Në vitin 2022, NJP-ja përktheu dhe dorëzoi mbi 15.500 faqe përkthime me shkrim në tri gjuhët zyrtare të DHSK-së, si dhe në gjuhë të tjera sipas nevojës, në shërbim të efektivitetit të punës dhe funksionimit të papenguar të Gjykatës dhe komunikimeve të jashtme të saj. Krahas përkthimit me shkrim të një numri të madh parashtrimesh, ku përfshihen edhe përkthimet në gjuhën shqipe dhe serbishte të aktgjyqimit të parë të DHSK-së, NJP-ja bëri edhe përkthime të informimeve javore për median, të njoftimeve për shtyp dhe materialeve të tjera informuese dhe ndërgjegjësuese, udhëzuesve të punës, raporteve të Avokatit të Popullit, kërkesave për pjesëmarrje të viktimave dhe të korrespondencës me palë të jashtme.

Në të njëjtën periudhë NJP-ja ofroi edhe shërbime të përkthimit simultan në 71 seanca gjyqësore dhe 46

informime javore për median si dhe shërbime përkthimi simultan dhe konsektiv në takimet dhe mbledhjet e mbajtura në selinë e DHSK-së dhe gjatë misioneve jashtë vendit. Krahas kësaj, NJP-ja u ofroi mbështetje njësisë të tjera në lidhje me kërkesat ad hoc për shërbime përkthimi me gojë, shkrim apo ndihmë tjetër gjuhësore.

Për të rritur kapacitetet e njësisë për përballimin e kërkesave në rritje për përkthime me shkrim dhe me gojë, NJP-ja organizoi trajnime të brendshme për përkthimin me gojë dhe për redaktimin e përkthimeve me shkrim, dhe kreu punë të gjerë kërkimore në tregun e shërbimeve të përkthimit për të evidentuar dhe testuar profesionistë të kësaj fushe me njohuritë dhe përvojën e duhur gjuhësore. Ky projekt ka vazhduar edhe pas vitit 2022.

Në vitin 2022, NJP-ja përktheu mbi 1.000 dokumente në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës dhe në gjuhë të tjera, sipas kërkesave.

4.3 | Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarave dhe të akuzuarve të cilët nuk zotërojnë ose zotërojnë pjesërisht mjete financiare. Një prej funksioneve të saj është edhe administrimi i Listës së Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit në DHSK si mbrojtës të specializuar. Në fund të vitit 2022, në këtë listë ishin pranuar 119 mbrojtës të specializuar dhe 85 që plotësonin kriteret për të ushtruar profesionin si mbrojtës të specializuar dhe si mbrojtës të viktimave. Procesi i paraqitjes së kërkesave për pranim në Listë është ende i hapur. Në vitin 2022, asnjë nga të akuzuarit nuk mori ndihmë juridike nga DHSK-ja.

ZM-ja është e paanshme dhe nuk ka asnjë rol në procedimin konkret të çështjeve gjyqësore në DHSK. Ajo shërben si pikë kontakti për çdo problem

administrativ që mund të kenë ekipet e mbrojtjes me Zyrën Administrative. ZM-ja u dha udhëzime të gjitha ekipeve të Mbrojtjes se si të paraqisnin kërkesë për pranimin e anëtarëve të ekipeve të tyre dhe më pas hartoi memorandume dhe letra për pranimin e tyre në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit. Kjo zyrë ka punuar për t'ua bërë sa më të lehtë mbrojtësve të specializuar dhe anëtarëve të ekipeve të tyre përfshirjen në sistemin e DHSK-së. Me fillimin e aktiviteteve të këtyre ekipeve, Zyra e Mbrojtjes bashkërendoi punën me NJAGJ-në për ofrimin e trajnimeve mbi përdorimin dhe qasjen në sistemin elektronik të administrimit gjyqësor *Legal Workflow*. ZM-ja gjithashtu u kujdes që të plotësoheshin nevojat për pajisje elektronike dhe që ekipeve t'u siguroheshin zyra të përshtatshme në selinë e DHSK-së.

Në vitin 2022, ZM-ja kontribuoi në testimin e sistemit *Legal Workflow* në të gjithë Gjykatën, duke koordinuar procesin dhe duke analizuar rezultatet e testimit. Ajo gjithashtu vazhdoi angazhimin në aspekte që lidheshin me përdorimin e sistemit duke mundësuar takime me përdoruesit dhe duke ia përcjellë kërkesat e tyre administratorëve të sistemit.

Gjithashtu, ZM-ja lehtësoi komunikimin ndërmjet ekipeve të mbrojtjes nga njëra anë, dhe shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera, nga ana tjetër, në lidhje me kërkesat hetimore të ekipeve të mbrojtjes.

4.4 | Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në DHSK. ZPV-ja u ofron ndihmë dhe këshilla personave që dëshirojnë të marrin pjesë në proces si viktimë, përpunon kërkesat e tyre në mënyrë konfidenciale dhe të sigurt dhe ia dorëzon ato trupit gjykues përkatës për të marrë vendim në lidhje me to. Pas pranimit të tyre si viktimë pjesëmarrëse në proceset para DHSK-së, ZPV-ja siguron që viktimat e pranuar të përfaqësohen në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim, ZPV-ja mban një listë të mbrojtësve që plotësojnë kriteret për të përfaqësuar viktimat. Në fund të vitit 2022, numri i mbrojtësve të pranuar për të përfaqësuar viktimat në proceset e DHSK-së ishte 115. ZPV-ja administron gjithashtu sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse.

Viktimat që marrin pjesë në proceset gjyqësore në DHSK gëzojnë disa të drejta, ndër të cilat të drejtat për njoftim, pranim dhe zhdëmtim. Ato i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësit të viktimave, që caktohet për një grup viktimash në secilën çështje gjyqësore. Mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore, t'u përgjigjet parashtrimeve të palëve, si dhe i mban viktimat të informuara gjatë gjithë procesit. Mbrojtësi i viktimave merr mendimet e viktimave, dëgjon shqetësimet e tyre dhe i sjell ato në vëmendje të gjykatësve.

Viti 2022 shënoi arritje të mëtejshme në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e viktimave. Me rekomandim të ZPV-së, Administratorja caktoi mbrojtësin e viktimave në çështjen gjyqësore kundër z. Pjetër Shala, duke siguruar kështu përfaqësimin e viktimave pjesëmarrëse në çështjen e tretë gjyqësore që po gjykohet në DHSK. Numri i viktimave pjesëmarrëse gjithashtu u rrit. Në vitin 2022 u miratua statusi i viktimave pjesëmarrëse në proces në DHSK edhe për 40 persona të tjerë që kishin bërë kërkesë, duke e çuar në 69 numrin e gjithsejtë të tyre që nga viti 2020: tetë në çështjen kundër z. Salih Mustafa, tetë në çështjen kundër z. Shala dhe 53 në çështjen kundër z. Hashim Thaçi dhe të tjerëve.

Në çështjen gjyqësore kundër z. Mustafa, që ishte çështja e parë që kaloi në gjykim në DHSK, u pa në praktikë tërësia e modaliteteve të pjesëmarrjes së viktimave, sikurse përcaktohet në kornizën ligjore. Mbrojtësja e viktimave mbajti deklarata hyrëse dhe përmbyllëse, bëri parashtrime me shkrim dhe me gojë, mori në pyetje dëshmitarë, propozoi ekspertë dhe i paraqiti Trupit Gjyqësor kërkesa për zhdëmtim. Gjithashtu, një viktimë pjesëmarrëse i paraqiti mendimet dhe shqetësimet e veta Trupit Gjyqësor në sallën e gjyqit.

Në vitin 2022, numri i viktimave pjesëmarrëse u rrit me 40, duke e çuar në 69 numrin e gjithsejtë të tyre.

4.5 | Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Gjatë vitit 2022, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) vazhdoi punën për garantimin e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, të dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore. ZMMD-ja mundësoi paraqitjen e sigurt dhe në kohë të dëshmitarëve para dy trupave gjykues. Në vitin 2022, në Gjykatë u paraqitën 19 dëshmitarë dhe një viktimitë në çështjen gjyqësore kundër z. Mustafa, dhe tre dëshmitarë në çështjen gjyqësore kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj. ZMMD-ja u ofroi atyre mbështetje, mbrojtje dhe ndihmë tjetër të përshtatshme dhe të nevojshme për dhënien e dëshmimeve të tyre, si dhe përgatiti paraqitjen e viktimave dhe dëshmitarëve të tjerë në çështjen kundër z. Shala.

Ndër të tjera, ZMMD-ja organizoi dhe bashkërendoi të gjitha aspektet logjistike të udhëtimit të dëshmitarëve, për të siguruar ardhjen e sigurtë të tyre në vendin e dhënies së dëshmisë. Kjo përfshinte koordinimin e ngushtë me shtetin pritës dhe autoritete të tjera. ZMMD-ja vlerësoi nevojat e dëshmitarëve dhe u dha atyre informacion mbi organizimin e udhëtimeve dhe paraqitjen e tyre në Gjykatë. Kur u gjykua e nevojshme, dëshmitarët u shoqëruan, ose për ta u zbatuan masa mbrojtëse shtesë. Në vitin 2022, personeli i ZMMD-së kreu gjithsej 30 misione për shoqërimin e dëshmitarëve. Gjatë qëndrimit të dëshmitarëve në vendin e dhënies së dëshmisë, personeli i ZMMD-së ishte në dispozicion të tyre 24 orë në ditë, çdo ditë, dhe atyre iu siguroa strehim, ndihmë mjekësore dhe çdo ndihmë tjetër e nevojshme. Gjithashtu, çdo dëshmitar u njoh me planimetrinë e sallës së gjyqit në një gjuhë që e kuptonte, iu paguan shpenzimet dhe iu dha mbështetja e duhur gjatë tërë kohës së qëndrimit. Gjatë këtij viti dëshmitarëve iu kushtuan 123 ditë shërbimesh mbështetjeje dhe ndihme.

ZMMD-ja gjithashtu vazhdoi të kryente vlerësime psikologjike dhe u ofroi mbështetje psikologjike dhe këshillim të posaçëm dëshmitarëve para dhe gjatë dhënies së dëshmisë. Në vitin 2022, 22 dëshmitarë dhe një viktimitë patën 110 kontakte me psikologjen. Shpeshtësia dhe intensiteti i shërbimeve varej në përgjithësi nga vlerësimet për nivelin e cenueshmërisë dhe masat mbështetëse të nevojshme. Me urdhër të Trupit Gjykues, një dëshmitar në çështjen kundër z. Mustafa dha dëshmi me praninë e personelit të ZMMD-së në sallën e gjyqit, për mbështetje psikosociale.

Aty ku ishte e përshtatshme, ZMMD-ja i trajtoi nevojat për siguri të dëshmitarëve që përfunduan dëshminë në bashkëpunim me palën thirrëse, dhe u ofroi mbrojtje dëshmitarëve dhe familjeve që u vlerësuan se përballëshin me nivel të lartë rreziku për shkak të dëshmimeve të tyre. Me kërkesë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZMMD-ja gjithashtu kreu vlerësime individuale të rrezikut për dëshmitarët dhe, sipas rastit, bëri rekomandime për zbatimin e masave mbrojtëse në sallën e gjyqit për të garantuar sigurinë e tyre. ZMMD-ja gjithashtu rekomandoi zbatimin në Gjykatë të masave të posaçme ose mbrojtëse, për të mbrojtur dëshmitarët e cenueshëm dhe dinjitetin e privatësinë e tyre gjatë gjithë procesit. ZMMD-ja vazhdoi të bashkëpunonte me partnerët përkatës vendorë dhe ndërkombëtarë në këtë aspekt.

Në vitin 2022, ZMMD-ja mundësoi paraqitjen në kohë në Gjykatë të 22 dëshmitarëve dhe një viktime dhe siguroi mbështetjen dhe mbrojtjen e tyre.

4.6 | Njësia e Paraburgimit

Njësia e Paraburgimit (NJP) drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet në mjediset e një burgu holandez në Hagë. Njësia e Paraburgimit siguron që të paraburgosurit të jenë të mbrojtur dhe të sigurt dhe garanton respektimin e plotë të dinjitetit dhe të drejtave të tyre në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit të DHSK-së, rregulloret, praktikat më të mira dhe të gjitha standardet ndërkombëtare përkatëse. Në vitin 2022, në objektin e paraburgimit të DHSK-së ishin tetë të paraburgosur.

Gjatë gjithë vitit 2022, Njësia e Paraburgimit vazhdoi kryerjen e veprimtarive standarde që zbatoheshin para pandemisë së KOVID-19, por edhe risitë që u krijuan gjatë pandemisë. Krahas kapaciteteve operative për të siguruar pjesëmarrjen fizike të të paraburgosurve në proceset gjyqësore, vijuan të zbatoheshin zgjidhjet teknologjike që mundësuan pjesëmarrjen nga distanca të të paraburgosurve në këto procese.

DHSK-ja është e angazhuar për t'u siguruar të paraburgosurve kohën dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre në përputhje me praktikat më të mira në këtë fushë. Të paraburgosurve iu vu në dispozicion një sistem i posaçëm për shkëmbimin e mbrojtur elektronik të të dhënave dhe, sipas rastit, krahas vizitave të zakonshme me prani fizike dhe shkëmbimit të dokumenteve, atyre iu krijua mundësia edhe e kontakteve me mbrojtësit përmes videolidhjes.

Po kështu, në kuadër të përpjekjeve për të optimizuar mbajtjen e kontakteve të njëmendta të të paraburgosurve me familjet dhe miqtë, në korrik 2021 vazhdoi mundësia e organizimit të vizitave përmes videolidhjes, edhe pas rifillimit të të gjitha vizitave personale të anëtarëve të familjes dhe vizitorëve të tjerë.

Gjatë vitit 2022, u kryen disa vizita dhe inspektime të pavarura për të siguruar respektimin e të drejtave të të paraburgosurve. Në mars, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) kreu inspektimin e dytë të pavarur në objekt. Qëllimi i inspektimeve të KNKK-së është të vlerësojnë përshtatshmërinë e kushteve ku mbahen të paraburgosurit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të paraburgimit, siç përcaktohet edhe në kornizën ligjore të DHSK-së. Gjatë këtyre vizitave, KNKK-ja bën takime individuale me të paraburgosurit e DHSK-së. Nga ana e tij, edhe Avokati i Popullit i DHSK-së kreu inspektimin e tij të dytë dhe të tretë në objekt, për të vlerësuar kushtet e paraburgimit në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe Provave.

Në vitin 2022, Njësia e Paraburgimit administroi më se 880 vizita nga familjarë dhe vizitorë të tjerë personalë në objektin e paraburgimit të DHSK-së.



Objekti i paraburgimit i DHSK-së

5 | Seksioni i Administratës

Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore, Njesisë së Teknologjisë së Informacionit, Njesisë për Administrimin e Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme, Njesisë së Sigurisë, Njesisë së Financave dhe Buxhetit dhe Njesisë së Prokurimit.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, kur shteti pritës hoqi kufizimet e vëna për shkak të pandemisë së KOVID-19, u mundësua kthimi i plotë i punonjësve në mjediset e Gjykatës. Puna e Seksionit të Administratës u përqendrua në lehtësimin e zhvillimit të procedurave gjyqësore, përfshirë mundësimin e kryerjes së aktiviteteve hibride në sallën e gjyqit, mbështetje për zbatimin e sistemit elektronik të administrimit të Gjykatës, *Legal Workflow*, zbatimin e vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake dhe të Paneleve të Apelit, ku Njësia e Sigurisë organizoi me sukses dhe brenda një kohe të shkurtër vizitat për arsye humanitare të disa të paraburgosurve në Kosovë.

Shefi i Seksionit të Administratës të DHSK-së në cilësinë e personit të kontaktit kundër mashtrimeve, së bashku me audituesen e brendshme dhe një punonjës të Seksionit të Administratës zbatuan planin e veprimit të DHSK-së kundër mashtrimit dhe organizuan trajnime ndërgjegjësuese kundër mashtrimit për punonjësit. Në trajnimet e organizuara në vitin 2022 morën pjesë 92 për qind e punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së.

Në vitin 2022, DHSK-ja dhe ZPS-ja gjithashtu përfunduan inventarizimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të pajisjeve të bartshme.



5.1 | Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. NJBNI-ja vazhdoi kryerjen e detyrave të saj përmes ofrimit të ndihmës në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve, administrimit dhe këshillimit të tyre për një sërë çështjesh të personelit - që nga

kompensimet dhe përfitimet, deri tek aspekte të mirëqenies dhe sigurimit shëndetësor; ofrimit të mbështetjes për punonjësit dhe drejtuesit gjatë procesit të rinovimit të kontratave, vlerësimit të punës së punonjësve, dhe ofrimit të mundësive për zhvillimin profesional dhe të njohurive të punonjësve.

Gjatë vitit 2022 u shpallën tri ftesa për aplikime për vende pune dhe një ftesë për praktikë profesionale. Gjithsej 685 aplikantë (261 femra dhe 424 meshkuj) dorëzuan 1.449 aplikime në kuadër të dy ftesave për aplikime për vende pune që u mbyllën gjatë këtij viti. Gjithashtu, në kuadër të ftesës për aplikime për praktikë profesionale u paraqitën 292 kërkesa nga 104 aplikantë (62 femra dhe 42 meshkuj). Në vitin 2022, në DHSK dhe ZPS filluan punë 55 punonjës të rinj, nga të cilët 31 femra dhe 24 meshkuj, dhe 33 praktikantë, nga të cilët 24 femra dhe 9 meshkuj. Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së, marrë së bashku, u rrit nga 268 punonjës më 31 dhjetor 2021, në 276 punonjës më 31 dhjetor 2022. Nga 204 punonjës në DHSK, 101 ishin femra dhe 103 meshkuj, dhe nga 72 punonjës në ZPS, 29 ishin femra dhe 43 meshkuj.

Në vitin 2022, katër shtete anëtare të BE-së (Bullgaria, Gjermania, Hungaria dhe Irlanda) si dhe dy shtete të treta kontribuese (Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) emëruan për punësim në DHSK dhe ZPS 10 punonjës, si dhe Prokurorin e Specializuar.


Gjatë vitit 2022, NJBNJ-ja vazhdoi forcimin e proceseve të brendshme dhe zgjeroi më tej automatizimin e procedurave për të rritur efikasitetin e shërbimeve të saj. Në tetor NJBNJ-ja mori pjesë në një aktivitet për karrierën dhe talentin dhe organizoi një seminar mbi programin e praktikës profesionale në kuadër të ekosistemit të paqes dhe drejtësisë në Hagë. Në vazhdim të angazhimit të drejtuesve të lartë të institucioneve për integrimin gjinor në DHSK dhe ZPS, NJBNJ-ja vazhdoi të fokusohet në këto çështje gjatë trajnimeve fillestare për punonjësit e rinj dhe trajnimeve për anëtarët e paneleve përzgjedhëse të rekrutimit. Në koordinim me Kabinetin e Administratores, NJBNJ-ja vazhdoi përditësimin e kornizës rregulatore të saj. Në nëntor 2022, Administratorja miratoi disa ndryshime në Rregulloren për Punonjësit, pas konsultimeve me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar, dhe komenteve të marra nga Organi Përfaqësues i Punonjësve të DHSK-së.

Në përputhje me prioritetet e përcaktuara për vitin 2022, NJBNJ-ja u kujdes që punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së t'u ofroheshin trajnime fillestare, mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional lidhur me aspekte të administrimit të punës, kurse për mësimin e serbishtes dhe të shqipërisë dhe të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, përmes qasjes së vazhdueshme në rrjetin e mësimin digjital, punonjësve iu mundësua ndjekja e më shumë se 85 kurseve me tema nga më të ndryshmet si drejtimi dhe administrimi, komunikimi dhe mirëqenia e punonjësve. Me mbështetjen që i dhanë drejtuesit e lartë strategjisë kundër ngacimit të DHSK-së dhe politikës së tolerancës zero ndaj të gjitha formave të ngacimit, NJBNJ-ja siguroi që pothuajse 100% e punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së të përfundonin trajnimin mbi "parandalimin e ngacimit psikologjik dhe seksual" dhe atë mbi "Paragjykimet e pavetëdijshme, diversiteti dhe gjithpërfshirja".


Sa i përket detyrës së përkujdesjes për punonjësit, NJBNJ-ja vazhdoi t'i mbështeste punonjësit gjatë pandemisë së KOVID-19, si edhe pas kthimit në zyrë në Gjykatë. Në prani të mjekut, u bënë prezantime ndërjegjësuere për të gjithë punonjësit lidhur me pandeminë KOVID-19. Gjatë gjithë vitit vazhdoi puna për promovimin e mirëqenies së punonjësve dhe mundësimin e shërbimeve të këshillimit psikologjik.

Në mbështetje të objektivit të drejtuesve të lartë për të siguruar një mjedis pune të sigurt dhe gjithpërfshirës dhe për të rritur shkallën e ndërjegjësimin, në vitin 2022, NJBNJ-ja organizoi trajnimet mbi "parandalimin e ngacimeve psikologjike dhe seksuale" dhe mbi "Paragjykimet e pavetëdijshme, diversiteti dhe gjithpërfshirja" për pothuajse 100% të të gjithë punonjësve të DHSK-së.

Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së



Përfaqësimi i punonjësve në DHSK dhe ZPS sipas shteteve 31 Dhjetor 2022



5.2 | Njësia e Teknologjisë së Informacionit

Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) mbështeti me shërbime 62 ditë seancash hibride në sallën e gjyqit, gjatë të cilave u krijuan dhe përpunuan 5.000 materiale audiovizuale me 9 terabajt të dhëna në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës. Në seancat hibride u përfshinë pjesëmarrës që ishin të pranishëm në sallën e gjyqimit dhe pjesëmarrës në distancë dhe, sipas nevojës, u morën masa për lidhje nga shtëpia, me pajisje të sigurta për videolidhje. Në vitin 2022, krahas aktiviteteve në sallën e gjyqit, u ofrua mbështetje teknike edhe gjatë konferencave për shtyp të DHSK-së dhe për kalimin e 220 incizimeve të seancave gjyqësore në kanalën e DHSK-së në *YouTube*. NJTI-ja u përqendrua gjithashtu në blerjen e pjesëve rezervë për pajisjet për t'iu përgjigjur shpejt çdo defekti të mundshëm të pajisjeve dhe për të shmangur çdo ndërprerje të proceseve gjyqësore, duke pasur parasysh se DHSK-ja ka vetëm një sallë gjyqi.


Aplikacioni kryesor që përdoret në DHSK është sistemi elektronik i administrimit gjyqësor *Legal Workflow*. Ai është një aplikacion i posaçëm përmes të cilit administrohen të gjitha aktivitetet dhe komunikimet gjyqësore. Numri i përdoruesve të sistemit si dhe i parashtimeve të protokolluara, vendimeve, përkthimeve dhe provave të nxjerra që janë përpunuar përmes këtij sistemi, u rrit në mënyrë të ndjeshme. Vetëm në vitin 2022, përmes sistemit *Legal Workflow* u vunë në dispozicion mbi 200.000 materiale të reja. Për t'iu përgjigjur këtij vëllimi në rritje dhe për të ofruar ndihmën teknike shtesë që nevojitej, NJTI-ja ofroi mbështetje edhe jashtë orarit zyrtar të punës, për të ndihmuar palët që të respektonin afatet e vendosura nga gjykatësit. NJTI-ja vazhdoi punën për forcimin e programeve kompjuterike dhe proceset e testimit dhe zbatimit të tyre në përputhje me praktikën e mira për administrimin e riciklimit të programeve kompjuterike.

Sektori i shërbimeve i NJTI-së ofroi mbështetje për përafërsisht 400 përdorues. Paralelisht me këtë, sektori i shërbimeve punoi në vijimësi për rinovimin,

zëvendësimin dhe heqjen nga përdorimi të pajisjeve të përdoruesve fundorë, në kuadër të proceseve të menaxhimit të cikleve të përdorimit dhe të administrimit të aseteve.

Në vitin 2022, NJTI-ja filloi procesin e rinovimit të pajisjeve kryesore kompjuterike, përmes sistemeve të BE-së për blerjen e mallrave dhe kontratave të posaçme të prokurimit për pajisje më të mëdha si sistemet e ruajtjes së të dhënave. Për të ruajtur informacionet sensitive për përdorim të brendshëm, në Gjykatë u krijuan, konfiguruan dhe instaluan sisteme të veçanta. U vendos në të gjithë organizatën një sistem i ri mbrojtës i internetit, që u përforcua me një program të specializuar kompjuterik i cili siguron kontroll dhe dukshmëri më të madhe të të gjithë serverëve dhe kompjuterave. NJTI-ja hartoi afate për krijimin e kopjeve rezervë të të dhënave të kompjuterëve dhe përcaktoi objektivat për rikuperimin dhe për nivelin maksimal të humbjes së të dhënave, që tani mbahen parasysh në hartimin e politikave të administrimit të informacionit në DHSK.

Për të garantuar aftësinë e sistemit për t'iu qëndruar defekteve teknike në kontekstin e një tregu me çmime të larta të kapaciteteve dhe pajisjeve, NJTI-ja ka përshtatur teknologjinë, kontratat dhe blerjet, duke thjeshtuar proceset dhe duke ruajtur pajisjet dhe pjesët e këmbimit të blera më parë.



5.3 | Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për administrimin efikas dhe të efektshëm të mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, për të siguruar një mjedis pune cilësor për punonjësit dhe vizitorët e institucionit. Ndër të tjera, ajo ofron shërbime mbështetëse në lidhje me administrimin e pasurive të paluajtshme në konsultim me autoritetet përkatëse të shtetit pritës, mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ndërtimet, si dhe planifikimin e hapësirave të brendshme. Njësia kryen gjithashtu edhe shërbime të tilla si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve, dhe pastrimi, si dhe administron shërbimin e protokollit, postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin, udhëtimet dhe logjistikën, në lidhje me të cilat bashkëpunon me Njësinë e Sigurisë dhe me Protokollin.

Në vitin 2022, NJAOSHP-ja vazhdoi të ishte në krye të punës për zbatimin e masave fizike të nevojshme për përshtatjen e mjediseve me kushtet e pandemisë KOVID-19. Zbatimi i masave parandaluese dhe lehtësuese dhe përshtatja e mjediseve, ishin me rëndësi kyçe për të mundësuar përcjelljen e seancave prej publikut nga galeria për publikun dhe prej mediave nga dhomat e përgatitura posaçërisht për to.

Gjatë vitit 2022, NJAOSHP-ja bashkëpunoi ngushtësisht me Agjencinë Qendrore të Pasurive të Paluajtshme të Holandës për hartimin e një kontrate të re për mirëmbajtjen e mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, që u kurorëzua me nënshkrimin e një kontrate të rishikuar për mirëmbajtjen e mjediseve, e cila hyri në fuqi nga shtatori 2022 e do të vazhdojë deri në fund të vitit 2025. Marrëveshja e re mbulon të gjitha aspektet që lidhen me mjediset si, ndërtesa, sistemet e teknologjisë së informacionit dhe ato audiovizuale si dhe mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë dhe zëvendësimin e komponentëve kryesorë të ndërtesës si sistemet e ngrohjes dhe ajrimit dhe ofron më shumë fleksibilitet për kryerjen e punimeve që lidhen me kërkesat operative.

Në vitin 2022, NJAOSHP-ja nënshkroi një kontratë të re për mirëmbajtjen e ndërtesave të DHSK-së dhe ZPS-së duke filluar nga shtatori 2022 deri në fund të vitit 2025.

5.4 | Njësia e Sigurisë

Gjatë vitit 2022, Njësia e Sigurisë (NJS) vazhdoi punën për përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e efektivitetit të masave të miratuara për evidentimin dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë. NJS-ja realizoi një numër të madh shërbimesh në këtë drejtim. Ajo mbështeti drejtpërdrejt proceset gjyqësore duke zbatuar masat e sigurisë në sallën e gjyqit dhe në galerinë për publikun gjatë seancave, si dhe kreu shërbime për ruajtjen e të paraburgosurve në këto mjedise.

Heqja e kufizimeve të lidhura me pandeminë COVID-19 nga shteti pritës dhe veprime të ngjashme të ndërmarra nga një numër shtetesh anëtare të BE-së mundësuan rifillimin e plotë të detyrave operative. Rifilluan gjithashtu edhe aktivitetet e trajnimit të jashtëm si Trajnimi i Ndërgjegjësimit për Mjedisin Armiqësor (TNMA) dhe programe të tjera trajnimi të lidhura specifiku me detyrat e punonjësve, që janë pjesë e rëndësishme e punës për rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve për rreziqet dhe të njohurive të tyre për masat për zbutjen e këtyre rreziqeve.

Planifikimi efikas i burimeve njerëzore është element kyç për NJS-në, si njësia më e madhe në DHSK dhe ZPS. Për këtë qëllim, NJS-ja mori masa që të kishte kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur brenda një kohe të shkurtër fillimin e gjyqimit me disa të akuzuar dhe mbajti numrin e nevojshëm të personelit gjatë gjithë vitit 2022 për t'iu përgjigjur kërkesave operative.

Krahas sigurimit të respektimit të detyrimeve ligjore lidhur me masat e sigurisë në ndërtesat e institucionit, NJS-ja mbikëqyri kryerjen e një vlerësimi të thelluar nga një partner i jashtëm të rreziqeve ndaj sigurisë profesionale në këto ndërtesa. Gjatë vitit 2022, NJS-ja vazhdoi bashkëpunimin efektiv me aparatet e sigurisë të shtetit pritës. Së fundi, në zbatim të vendimeve të paneleve përkatëse, NJS-ja planifikoi dhe realizoi brenda një kohe të shkurtër pesë vizita nën ruajtje të të paraburgosurve në Kosovë për arsye humanitare.

Mbështetja e aktiviteteve gjyqësore si dhe shërbimet për ruajtjen dhe sigurinë e të paraburgosurve në mjediset përkatëse, u realizuan me sukses të plotë dhe pa asnjë incident.



5.5 | Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren në administrimin financiar dhe përdorimin e fondeve që i janë akorduar DHSK-së, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe të BE-së, si dhe për zbutjen e rreziqeve financiare për DHSK-në. Gjatë vitit 2022, NJFB-ja vazhdoi punën për një administrim sa më efikas dhe autonom dhe për ndërtimin e një cikli financiar më të qëndrueshëm, me qëllim miradministrimin financiar të fondeve. Gjithashtu, gjatë këtij viti u përditësuan një direktivë administrative dhe tre udhëzime operative në lidhje me proceset me ndikim financiar. Për forcimin e mëtejshëm të procedurave dhe të njohurive, NJFB-ja organizoi rregullisht trajnime të brendshme për punonjësit lidhur me aspektet kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Gjatë vitit 2022, DHSK-ja administroi fondet e akorduara nga BE-ja në përputhje me Marrëveshjen e Pestë për Subvencionim, që u nënshkrua nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së dhe nga Komisioni Evropian (Marrëveshja e Subvencionimit), për periudhën dyvjeçare 15 qershor 2021 - 14 qershor 2023 në shumën prej 103.279.698 euro. Krahas fondeve të akorduara nga BE-ja, DHSK-ja administroi edhe shumën prej 147.000 euro, të akorduara nga qeveria zvicerane për aktivitetet e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së në vitet 2022 dhe 2023. Në vitin 2022, NJFB-ja kreu më se 3.500 veprime financiare në kuadër të angazhimeve buxhetore për pagesat dhe numri i veprimeve financiare gjatë këtij viti ishte përgjithësisht më i lartë se në vitin paraardhës.

Gjatë vitit 2022, u dorëzuan raporti paraprak mbi Marrëveshjen e Pestë për Subvencionim nga BE-ja për periudhën 15 qershor 2021 - 14 qershor 2023, si dhe raporti përfundimtar mbi Marrëveshjen për Subvencionimin e aktiviteteve të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së nga qeveria zvicerane për vitet 2020 dhe 2021. Në kuadër të kornizës rregullore të DHSK-së dhe të financimit nga BE-ja, kryhen rregullisht auditime të pavarura dhe verifikime të shpenzimeve në llogaritë financiare të DHSK-së, si nga auditues të brendshëm ashtu dhe të jashtëm. Në vitin 2022, auditimet dhe verifikimet e shpenzimeve të kryera nuk konstatuan asnjë parregullsi. NJFB-ja vazhdoi të zhvillonte dhe forconte bashkëpunimin efektiv me Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) me qëllim monitorimin dhe zbatimin me efektivitet të burimeve financiare të DHSK-së.

Në vitin 2022, NJFB-ja vazhdoi punën për ndërtimin e një cikli më të qëndrueshëm financiar, për të siguruar në vijimësi miradministrimin financiar të fondeve të akorduara nga BE-ja dhe Zvicra.



5.6 | Njësia e Prokurimit

Roli kryesor i Njesisë së Prokurimit (NJP) është sigurimi në kohë dhe me çmimin e duhur i mallrave, shërbimeve apo punimeve të nevojshme për përmbushjen e mandatit të Gjykatës. Duke qenë se prokurimet janë një nga fushat me kornizë rregullatore më të plotësuar në sektorin publik, prokurimet e kryera nga DHSK-ja dhe ZPS-ja janë rregullisht objekt i kontrolleve dhe auditimeve të rrepta.

Në vitin 2022, NJP-ja punoi për të optimizuar më tej përdorimin e burimeve buxhetore për prokurimet për vitet në vazhdim, pa cenuar përmbushjen e mandatit të DHSK-së dhe ZPS-së. NJP-ja gjithashtu vazhdoi punën për të ndërgjegjësuar dhe për t'i informuar më tej ofruesit të ardhshëm të mallrave dhe shërbimeve për proceset dhe kriteret e tenderimit, si dhe për t'u ofruar sa më shumë kompanive mundësinë për të punuar me DHSK-në dhe ZPS-në, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Në të njëjtën kohë, Njësia e Prokurimit ofroi trajnime për personelin e DHSK-së dhe ZPS-së për të siguruar që administrimi i kontratave dhe proceset e anketimit të tregut të kryhen në mënyrë të njëtrajtshme dhe rigorozë. Me përpjekjet e saj Njësia e Prokurimit siguron pajtueshmërinë në tërësi me praktikën e mira në fushën e prokurimit si dhe minimizimin e rrezikut të mospajtueshmërisë me rregullat dhe rregulloret përkatëse të prokurimit, kryesisht me Udhëzuesin Praktik mbi Procedurat e Kontratave për Projekte të Jashtme të Financuara nga BE-ja – si dokumenti kryesor mbi të cilin mbështeten veprimtaritë e prokurimit të DHSK-së dhe ZPS-së – dhe me politikën dhe udhëzimet e brendshme. Në vitin 2022, NJP-ja zhvilloi një qasje me fokus më komercial brenda Gjykatës, me qëllim evidentimin e mundësive për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve dhe për kryerjen e prokurimeve sa më cilësore.

Në vitin 2022, për DHSK-në dhe ZPS-në u lidhën mbi 110 kontrata prokurimi për një sërë mallrash dhe shërbimesh, me një vlerë prej mbi 15.5 milion euro.



6 | Zyra e Auditimit

Auditimi i Brendshëm kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve dhe raportimit të konstatimeve dhe rekomandimeve Administratores. Nga ana e tyre, këto procese mbështesin DHSK-në dhe ZPS-në në përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të brendshme. Rekomandimet i jepen drejtuesve të njësive dhe audituesja e brendshme verifikon statusin e zbatimit të tyre në auditimet vijuese që kryen. Në punën e saj, audituesja u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe Rregullores Financiare të BE-së, dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.

Gjatë vitit 2022, audituesja e brendshme kreu shtatë auditime në bazë të planit vjetor të auditimit, duke u përqendruar në shpenzimet e llogarive të pagesave, tarifat e ndihmës juridike, shpenzimet në lidhje me shërbimet e paraburgimit, kontributet në fondin e pensionit dhe subvencionin e akorduar nga qeveria

zvicerane. Audituesja e brendshme kreu tetë auditime vijuese për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme, për të siguruar që veprimet për të cilat ishte rënë dakord me drejtuesit ishin zbatuar në mënyrë të saktë. Përveç detyrave të auditimit, audituesja e brendshme u angazhua edhe në trajnimet kundër mashtrimit që u organizuan për punonjësit e Gjykatës.

Gjatë çdo detyre auditimi, audituesja e brendshme vlerëson efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kontrollat e brendshme minimizojnë rreziqet dhe mbrojnë pasuritë, sigurojnë saktësinë e të dhënave, promovojnë efikasitetin operativ, dhe nxisin respektimin e politikave, rregullave dhe rregulloreve të brendshme.



Integrimi i perspektivës gjinore në DHSK dhe ZPS



1 | Integrimi i perspektivës gjinore dhe barazia në DHSK dhe ZPS

Drejtuesit e lartë të DHSK-së dhe ZPS-së vazhduan të kultivojnë një mjedis pune të sigurt dhe gjithëpërfshirës, konkretisht, duke marrë masa për të mbështetur parimin se çdo formë diskriminimi, ngacmimi ose shpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar, përfshirë ngacmimet psikologjike, seksuale ose gjinore, ose keqtrajtimet fizike ose verbale në vendin e punës ose në lidhje me punën, është e ndaluar. Masat përfshinë miratimin e Udhëzuesit kundër Ngacmimeve, organizimin e trajnimeve të posaçme për të gjithë punonjësit dhe vijimin e përpjekjeve për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor ndërmjet punonjësve.

Udhëzimi kundër ngacmimeve

Në vijim të miratimit të Strategjisë Kundër Ngacmimit në vitin 2019, më 2022 përfunduan konsultimet dhe hartimi i Udhëzimit kundër Ngacmimeve i DHSK-së dhe ZPS-së. Me kontributin e drejtuesve të lartë, Organit Përfaqësues të Punonjësve dhe personit të kontaktit për çështje gjinore të DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe mbi bazën e këshillave të një eksperti të pavarur për politikën kundër ngacmimit, më 21 dhjetor 2022, Administratorja miratoi Udhëzimin kundër Ngacmimeve.

Udhëzimi kundër Ngacmimeve përforcon politikën e tolerancës zero të DHSK-së dhe ZPS-së ndaj të gjitha formave të ngacmimit, duke rritur ndërgjegjësimin për parandalimin e tyre dhe reagimin ndaj ngacmimeve si dhe nxit më tej kulturën e dinjitetit dhe respektit brenda Gjykatës. Gjithashtu, Udhëzimi sqaron procedurat jozyrtare të zgjidhjes së konflikteve, të përcaktuara në Rregulloren për Punonjësit dhe në dokumentet e tjera rregullatore të brendshme mbi procedimin disiplinor, që plotësojnë procesin zyrtar të zgjidhjes së tyre.

Udhëzimi kundër Ngacmimeve përcakton dy mekanizma jozyrtarë për zgjidhjen e konflikteve – zgjidhjen e brendshme dhe ndërmjetësimin. Zgjidhja e brendshme, sikurse shpjegohet në Udhëzim, bëhet me përfshirjen e drejtuesit të nivelit të parë dhe/ose

shefit të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNI), ndërsa ndërmjetësimi përfshin një palë të tretë dhe bëhet nga ndërmjetës të jashtëm të pavarur. Për të mbështetur këtë përgjegjësi në rritje të drejtuesve si persona që ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve, Udhëzimi ofron trajnime të mëtejshme për ta. Gjithashtu, në Udhëzim parashihet paraqitja e raporteve vjetore me të dhëna statistikore anonime për rastet e ngacmimeve.


Shërbime të posaçme trajnimi dhe këshillimi

Në vitin 2022, për të thelluar njohuritë e punonjësve për rregulloret e DHSK-së dhe ZPS-së, politikën e tolerancës zero dhe vlerat e përbashkëta të organizatës, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe personi i kontaktit për çështjet gjinore punuan me trajnues me shumë përvojë për të hartuar programe trajnimi të Gjykatës për parandalimin e ngacmimeve psikologjike dhe seksuale dhe paragjykimeve të pavetëdijshme. Trajnimet ishin ndërvepruese dhe synonin aftësimin e punonjësve për të dalluar sjelljet abuzive dhe për të kuptuar llojet e ndryshme të ngacmimeve, si dhe propozimin e mënyrave të reagimit ndaj sjelljeve të ndaluara në pajtim me rregulloret e DHSK-së dhe ZPS-së. Pas trajnimit me temë “Parandalimi i ngacmimeve psikologjike dhe seksuale” në vitin 2021, ky kurs u ofrua edhe në vitin 2022, për të siguruar që krahas drejtuesve të nivelit të parë dhe të dytë të trajnoheshin edhe të gjithë punonjësit e tjerë. Në vitin 2022 u organizua edhe një kurs i ri, “Paragjykimet e pavetëdijshme, diversiteti dhe gjithëpërfshirja” dhe, deri në fund të vitit, pothuaj 100% e punonjësve e kishin kryer këtë trajnim të detyrueshëm.

Nga mendimet e marra pas trajnimeve rezultoi se punonjësit vlerësuan sidomos informacionin se si, së pari, të dallonin ngacmimet në një fazë të hershme dhe, së dyti, si të reagonin ndaj tyre. Punonjësit gjithashtu konstatuan se trajnimi mbi paragjykimet e pavetëdijshme i kishte ndihmuar të kuptonin paragjykimet që kishin dhe si të reagonin ndaj tyre.

Përfaqësimi gjinor në DHSK dhe ZPS

31 dhjetor 2022



Gjatë vitit, DHSK-ja dhe ZPS-ja vazhduan t'i inkurajonin punonjësit që të merrnin pjesë në trajnimin njëjavor me titull "Integrimi i perspektivës gjinore në trajnimin në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes", me personin e kontaktit për çështje gjinore, organizuar nga Zyra e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil të Shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian dhe Akademia Folke Bernadote.

Gjatë gjithë vitit 2022, punonjësit kishin mundësi të përdornin shërbimet e këshillimit psikologjik, për të kërkuar udhëzime dhe këshilla profesionale, dhe drejtuesit e lartë vazhduan mbështetjen e tyre për të gjitha përpjekjet për dhënien e çfarëdo ndihme të nevojshme për punonjësit.

Deri në fund të vitit 2022, pothuaj 100% e punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së kishin kryer trajnimet e detyrueshme "Parandalimi i ngacmimeve psikologjike dhe seksuale" dhe "Paragjykimet e pavetëdijshme, diversiteti dhe gjithëpërfshirja".

Puna për arritjen e barazisë gjinore

Ashtu si në vitet e mëparshme, u mbledhën dhe u analizuan rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi përfaqësimin gjinor, me synimin për të monitoruar përparimin e bërë në arritjen dhe ruajtjen e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e organizatës. Njësia e Burimeve Njerëzore vazhdoi të luajë një rol kyç në këto përpjekje, duke i vënë theksin integritet të perspektivës gjinore në trajnimet për punonjësit e rekrutuar shkas. Ky trajnim u organizua gjatë gjithë vitit edhe për të gjithë anëtarët e paneleve të rekrutimit të punonjësve.

Që nga viti 2018, përfaqësimi i femrave ndër punonjësit e rinj në DHSK dhe ZPS është përmirësuar vazhdimisht: në vitin 2018, vetëm 29% e tyre ishin femra; në vitin 2019, kjo përqindje arriti në 34%, dhe në vitin 2020 u arrit përfaqësim i barabartë gjinor ndër punonjësit e rinj. Kjo prirje në rritje vazhdoi edhe në vitin 2021, ku 56% e punonjësve të rinj ishin femra, dhe mbeti e pandryshuar në vitin 2022.

Në vitin 2022, DHSK-ja arriti përfaqësim të barabartë gjinor për vendet e punës në nivel ekspertit dhe drejtuesit, si dhe për numrin e përgjithshëm të punonjësve të saj. Së pari, në mars 2022, u arrit përfaqësim i barabartë gjinor në vendet e punës në nivel ekspertit dhe drejtuesit, me 45 femra dhe 45 meshkuj. Së dyti, në fillim të gushtit 2022, DHSK-ja arriti përfaqësim të barabartë gjinor në numrin e gjithsejtë të punonjësve, me 101 femra dhe 101 meshkuj.

Deri në fund të vitit 2022, 55% e punonjësve në nivel ekspertësh dhe drejtuesish ishin femra, dhe 45% meshkuj. Në vitin 2022, përfaqësimi gjinor në DHSK në nivel sekretari dhe asistenti vijoi të ishte mjaft i balancuar: 45% e punonjësve ishin femra, dhe 55% meshkuj. Sa i përket numrit të përgjithshëm të të punësuarve në DHSK, në fund të vitit u ruajt përfaqësimi i barabartë gjinor me 101 punonjëse femra dhe 103 punonjës meshkuj.

Në vitin 2022, ZPS-ja arriti përfaqësim të barabartë gjinor në nivel sekretari dhe asistenti, ndërsa raporti në nivel eksperti dhe drejtuesi pati një përmirësim të vogël krahasuar me vitin 2021, me 40% femra dhe 60% meshkuj. Sa i përket numrit të përgjithshëm të punonjësve, në ZPS pati një rritje prej 2% të numrit të punonjësve femra gjatë vitit, çka bëri që në fund të vitit 2022 ato të përbënin 40% të punonjësve. Nga numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së, më 31 dhjetor 2022, 47% ishin femra dhe 53% meshkuj. Kjo shënon një rritje të lehtë të numrit të punonjësve femra krahasuar me vitin 2021, kur 46% e punonjësve ishin femra dhe 54% meshkuj. Gjithashtu, në vitin 2022, tre nga pesë panelet e caktuara kryesoheshin nga gjykatëse dhe në më shumë se dy panele shumica e gjykatësve ishin femra.

Që nga krijimi i DHSK-së dhe ZPS-së, drejtuesit e lartë kanë nxitur organizimin e aktiviteteve për integrimin e perspektivës gjinore për të përmirësuar përfaqësimin gjinor. Si rezultat, është bërë përparim i rëndësishëm drejt përfaqësimit të barabartë gjinor. Në fund të vitit 2020, 38% e punonjësve ishin femra dhe 62% meshkuj, ndërsa në fund të vitit 2021, 46% ishin femra dhe 54% meshkuj. Në gusht 2022, DHSK-ja arriti të kishte përfaqësim të barabartë gjinor.

2 | Personi i kontaktit për çështjet gjinore

Prania e personit të kontaktit për çështjet gjinore është shprehje e përkushtimit të përgjithshëm të drejtuesve të lartë për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një mjedisi pune gjithëpërfshirës në DHSK dhe ZPS.

Gjatë vitit 2022, personi i kontaktit për çështjet gjinore organizoi një sërë aktivitetesh, mes të cilave edhe festimi në internet i Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Tema e vitit 2022 ishte “thyerja e paragjykimëve” dhe punonjësve iu kërkua të dërgonin një videomaterial të shkurtër për veten, ku të përshkruanin mënyrat e ndryshme – të mëdha apo të vogla – se si një punonjës tjetër i kishte bërë të ndjeheshin të vlerësuar ose të përfshirë. Këto videomateriale u shfaqën në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, dhe pas kësaj të pranishmit dëgjuan muzikë dhe shpenzuan kohë me njëri-tjetrin në hapësirën virtuale.

Gjatë vitit 2022, personi i kontaktit për çështjet gjinore organizoi seminare të mëtejshme mbi paragjykimet e pavetëdijshme, ku morën pjesë të gjithë punonjësit. Personi i kontaktit për çështjet gjinore shprehu gjithashtu mendimet e saj në lidhje me Udhëzimin kundër Ngacmimeve, që u miratua nga Administratorja më 21 dhjetor 2022.

Gjithashtu, personi i kontaktit për çështjet gjinore punoi për përditësimin e rregullt të faqes së

brendshme të internetit kushtuar kësaj teme, me artikuj interesantë dhe lidhje në internet për aktivitete që kishin të bënin në përgjithësi me përfaqësimin gjinor, gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.

Gjatë gjithë vitit, personi i kontaktit për çështjet gjinore mbajti kontakte të mëtejshme me homologët e saj në organizatat e tjera ndërkombëtare në Hagë, për të shkëmbyer njohuritë dhe praktikat më të mira lidhur me përpjekjet për integrimin e perspektivës gjinore, ndërsa në qershor 2022, mori pjesë në një takim vjetor treditör të këshilltarëve për të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore në kuadër të misionëve të Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian, të organizuar nga Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian.

Gjatë këtyre tri ditëve u prezantuan materiale mbi një seri temash që kishin lidhje, ndër të tjera, me, këshilltarët për çështjet gjinore në misionet e Shërbimit të Jashtëm, si dhe u organizuan seminare për perspektivën gjinore. Së fundi, personi i kontaktit për çështjet gjinore mori pjesë në një program intensiv trajnimi gjashtëjavor mbi zhvillimin e aftësive drejtuese, të organizuar për gratë me titull “Ja ku po vjen ajo!”

INTERNATIONAL
WOMEN'S
DAY




Personi i kontaktit për çështjet gjinore

DHSK

NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI




NIVEL DREJTUESI DHE EKSPERTI




ZPS

NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI



NIVEL DREJTUESI DHE EKSPERTI



Zyra e Prokurorit të Specializuar

A decorative graphic in the bottom right corner of the page, consisting of a grid of small, light-colored dots that form a pattern resembling a fingerprint or a stylized wave. The dots are arranged in a way that creates a sense of depth and movement, fading out towards the right edge of the page.

1 | Parathënie

Viti i kaluar ishte përsëri një vit arritjesh për Dhomat e Specializuara (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe, mbi të gjitha, për viktimat që më në fund – pas më se dy dekadash – patën mundësinë të dëshmojnë për përvojat e tyre dhe për dhimbjet e vuajtjet që pësuan ose panë. Përfunduan dy gjykimet e para; u dhanë verdiktet e para dhe u siguruan procedimet e para. Gjithashtu, me fillimin e dy gjykimeve të tjera dhe mundësinë që DHSK-ja do t'u ofrojë më shumë viktimave për të rrëfyer publikisht atë që kanë përjetuar, pësuar, apo parë, viti në vazhdim premtan të jetë po aq dinamik.

DHSK-ja është forum i rëndësishëm për vendosjen e drejtësisë për viktimat, sepse krijon një mjedis të sigurt ku dëshmitarët mund të flasin hapur për krimet që kanë parë apo përjetuar, pa pasur frikën se do të jenë objekt i frikësimit apo hakmarrjes. Megjithatë, edhe sot, viktimave u duhet guxim i jashtëzakonshëm për të dalë dhe për të folur pas kaq shumë vitesh heshtjeje. ZPS-ja nuk do të mund të kryente procedime penale pa guximin e shumë grave dhe burrave që kanë bashkëpunuar me hetimet tona në Kosovë dhe gjetkë, duke na dhënë dëshmi, duke rrëfyer historitë e tyre dhe të njerëzve të dashur të tyre dhe, mbi të gjitha duke i besuar këtij institucioni

në vendosjen e drejtësisë. Ne, tani duhet të sigurojmë që krimet e kryera kundër tyre të dalin plotësisht në dritë në Gjykatë dhe personat që kanë më shumë përgjegjësi për ato krime të përballen me drejtësinë.

Për më se katër vjet, duke filluar nga maji 2018 e deri në nëntor 2022, në krye të ZPS-së ishte Prokurori i Specializuar Xhek Smith. Kontributi i tij ishte i paçmuar. Ai i çoi hetimet përpara duke dhënë shembullin e tij - duke mbikëqyrur me kujdes rekrutimin e punonjësve të kualifikuar; mbledhjen, vlerësimin dhe nxjerrjen e provave; dhe hartimin e aktakuzave. Për më tepër, fokusi i tij i palëkundur e solli ZPS-në këtu ku është sot. Unë, si Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar, synoj ta çoj më tej punën e nisur nga Prokurori i Specializuar Smith dhe të siguroj përparimin e mëtejshëm të të gjitha aspekteve të punës së ZPS-së sa më shpejt që është e mundshme.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndër të cilët edhe shtetin pritës, Holandën, si dhe Norvegjinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara si shtete kontribuese, që vazhduan të ofrojnë burimet dhe mbështetjen e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit, që kanë bërë të mundur kryerjen e punës sonë. Gjithashtu, u shpreh mirënjohjen time Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe shefit të këtij Misioni, ambasadorit Lars-Gunar Vigemark, për mbështetjen logjistike dhe operative që i dhanë ZPS-së gjatë gjithë vitit të kaluar. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj punonjësit e ZPS-së, të tanishëm dhe të mëparshëm, si dhe punonjësit e DHSK-së, në veçanti Kryetaren Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, për angazhimin dhe përkushtimin e tyre të pandërprerë që mundësuan arritjet tona.

Aleks Uajting

Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar

Dhjetor, 2022



Aleks Uajting, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar

2 | Mandati i ZPS-së

ZPS-ja u themelua më 1 shtator 2016 mbi bazën e një ndryshimi kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.

Ky Ligj e autorizon ZPS-në të hetojë dhe ndjekë penalisht shtetas të Kosovës dhe/ose Republikës Federale të Jugosllavisë, apo persona të cilët kanë kryer krime kundër shtetasve të Kosovës dhe/ose Republikës Federale të Jugosllavisë, për krime të nisura ose të kryera në Kosovë që lidhen me sjelljet dhe veprimet e përmendura në Raportin e Këshillit të Evropës të janarit 2011 me titull Trajtimi Çnjerëzor i Personave dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve Njerëzore në Kosovë, gjatë periudhës trevjeçare nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000.



Ambasadori Clint Uilliamson

Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja u krijuan pas hetimit të kryer më parë nga Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) dhe ZPS-ja trashëgoi punonjësit dhe mandatin e TFHS-së. TFHS-ja u krijua për të hetuar dhe, nëse do të ishte nevoja, për të ndjekur penalisht persona për krimet e pretenduara në Raportin e Këshillit të Evropës. TFHS-ja ishte njësi e pavarur, juridiksioni dhe autoriteti ligjor i së cilës buronte nga Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian për themelimin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Hetimet e TFHS-së u drejtuan nga Klint Uilliamson, prokuror nga Shtetet e Bashkuara dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës. Në korrik 2014, ai raportoi se për përparimin e hetimeve, duhej të krijohet një gjykatë.

ZPS-ja është institucion i pavarur, pavarësia e së cilës garantohet nga Ligji që e krijoi atë. Rrjedhimisht, ZPS-ja ka detyrimin të veprjë në mënyrë të pavarur si nga Dhomat e Specializuara ashtu dhe nga të gjithë prokurorët e tjerë në Kosovë. Ligji gjithashtu e udhëzon Prokurorin e Specializuar dhe personelin e ZPS-së që të mos kërkojnë e as të marrin udhëzime nga ndonjë qeveri apo burim tjetër.

Në juridiksionin e tyre, Dhomat e Specializuara kanë përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. Dhomat e Specializuara ose ZPS-ja mund të urdhërojnë transferimin e procedurave që përfshihen në juridiksionin e tyre nga çdo prokuror apo gjykatë tjetër në territorin e Kosovës të Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja, në çfarëdo faze të hetimeve apo të proceseve gjyqësore.

Prokurori i Specializuar është i autorizuar të marrë në pyetje viktimat, dëshmitarët dhe të dyshuarit dhe të incizojë deklaratat e tyre, të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura dhe të kryejë veprimtari të tjera hetimore të nevojshme; të kërkojnë ndihmën e shteteve të treta dhe organizatave ndërkombëtare apo entiteteve të tjera; dhe të marrë masa hetimore sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

3 | Zbatimi i mandatit

Ndjekjet penale nga ZPS-ja përparuan me shpejtësi më 2022, vit në të cilin përfunduan dy gjykime. ZPS-ja u përfshi gjithashtu në debate juridike në fazat paraprake të dy çështjeve të tjera gjyqësore; ajo i dorëzoi prova ekipeve të Mbrojtjes dhe kreu hetime të mëtejshme.

ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave kundër drejtuesve të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, të cilët u dënuan për pengim të drejtësisë, frikësim të dëshmitarëve dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Ata u dënuan secili me katër vjet e gjysmë burgim dhe me gjobë prej 100 eurosh.

Gjykata konstatoi se veprimet e të akuzuarve “u kryen në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve”; se autoritetet në Kosovë dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) ishin përpjekur për vite me radhë të luftonin atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve “e cila ka pasur një ndikim të madh në hetimet dhe ndjekjen penale të krimeve”; dhe se të akuzuarit “e dinin mirë këtë”.

Pas dhënies së vendimit, Prokurori i Specializuar Xhek Smith u zotua se do të vazhdonte me forcë hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha rasteve të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrjes ndaj tyre dhe pengimit të drejtësisë.



*Në rreshtin e parë nga e majta: prokurorët Cezari Mihalçuk, Filipo De Miniçis dhe Silvia D'Askoli
Në rreshtin e dytë: Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar, Aleks Uajting*

Gjykimi i z. Gucati dhe z. Haradinaj filloi më 7 tetor 2021 dhe paraqitja e provave përfundoi më 3 shkurt 2022. ZPS-ja thirri katër dëshmitarë. Deklaratat përmbyllëse u bënë nga 14 deri më 17 mars 2022 dhe aktgjykimi u shqiptua më 18 maj 2022, pas 32 seancash gjykimi në sallën e gjyqit. Mbrojtësit e apeluar vendimin dhe konferenca para apelit u mbajt më 5 korrik 2022. Seancat e apelit u mbajtën më 1 dhe 2 dhjetor. ZPS-ja dorëzoi 23 parashtrime gjatë vitit 2022.

Gjithashtu, ZPS-ja përfundoi ndjekjen penale të Salih Mustafës, i cili u dënua për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme mbi bazën e përgjegjësisë penale individuale dhe përgjegjësisë penale si epror për krimet e kryera nga disa anëtarë të UÇK-së ndaj personave të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në Kosovë. Të gjitha viktimat ishin shqiptarë kosovarë. Z. Mustafa u dënua me 26 vjet burgim.

Pas verdiktit, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting e përshkroi atë si një fitore për drejtësinë dhe përshëndeti guximin e dëshmitarëve që dëshmuan gjatë gjyqit.



Prokurori i Specializuar Xhek Smith në sallën e gjyqit

Reagimi i Prokurorit të Specializuar pas verdiktit në gjykimin e Gucatit dhe Haradinajt

Pas vendimit në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, Prokurori i Specializuar Xhek Smith bëri një deklaratë në të cilën u shpreh se drejtësia ishte vënë në vend; se z. Gucati dhe z. Haradinaj u shpallën fajtorë për krimet e tyre pas një gjykimi transparent, të kujdesshëm dhe të drejtë; dhe se ZPS-ja do të vazhdonte me forcë hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha akteve të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrjes ndaj tyre, ose pengimit të drejtësisë.

“Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë aftësinë unike për të ofruar drejtësi për viktimat sepse përfaqësojnë një vend të sigurt ku dëshmitarët mund të flasnin hapur për krimet që kanë parë ose kanë pësuar më se 20 vjet më parë”, tha Prokurori i Specializuar. “Frikësimi ose hakmarrja ndaj këtyre viktimave është, për mendimin tim, një krim shumë i rëndë që cenon rëndë thelbin e aftësisë së këtij institucioni për të vendosur drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Nëse dikush kërkon të frikësojë dëshmitarët e kësaj Gjykate apo të hakmerret ndaj tyre, unë do të bëj gjithçka që është në fuqinë time që ta sjell para drejtësisë.

Gjykimi i z. Mustafa filloi më 15 shtator 2021 dhe ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave më 4 shkurt 2022. Më 1 qershor 2022, ZPS-ja paraqiti kundërprova dhe procedura e paraqitjes së provave u mbyll më 20 qershor 2022. Deklaratat përmbyllëse u bënë nga 13 shtatori deri më 15 shtator 2022 dhe aktgjykimi u shqiptua më 16 dhjetor 2022. Në lidhje me këtë çështje gjyqësore, në vitin 2022, ZPS-ja paraqiti gjithsej 14 dëshmitarë dhe dorëzoi 54 parashtrime.

ZPS-ja gjithashtu ka bërë përgatitjet për fillimin e gjykimit të Pjetër Shalës, ndaj të cilit janë ngritur katër akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, trajtim mizor torturë dhe vrasje e paligjshme – të kryera ndaj personave në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999.

Më 28 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi dosjen paraprake; më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykes; dhe më 18 dhe 19 tetor 2022, u mbajt konferenca përgatitore për gjykimin. Gjatë vitit 2022 u mbajtën gjithashtu edhe tri konferenca mbi ecurinë e çështjes dhe ZPS-ja dorëzoi 124 parashtrime në këtë çështje gjyqësore.

Gjatë gjithë vitit 2022 vazhdoi procedura paraprake në çështjen gjyqësore kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ndaj të cilëve janë ngritur gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë e personave – dhe katër akuza për krime lufte – arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme.



*Në rreshtin e parë nga e majta: prokurorët Filipo De Miniçis, Gaja Pergolo dhe Eva Uajllër.
Në rreshtin e dytë: Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting*

Sipas aktakuzës, krimet u kryen së paku nga marsi 1998 deri në shtator 1999 në disa vende në Kosovë, dhe në Kukës e Cahan në Shqipëri. Pretendohet se ato u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Në aktakuzë pretendohet se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi mbajnë përgjegjësi penale individuale në bazë të formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krime që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi dosjen paraprake, ndërsa më 24 shkurt 2022 ajo dorëzoi një version të përditësuar të saj. Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën me ndryshime të mëtejshme.



Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting në gjykatë

Në fazën paraprake, ZPS-ja mori pjesë në debate juridike intensive mbi një numër aspektesh siç ishin ato në lidhje me rishikimet çdo dy muaj të paraburgimit të të akuzuarve në përputhje me kornizën ligjore të Gjykatës. ZPS-ja kundërshtoi kërkesat për lirim të përkohshëm të të akuzuarve, duke argumentuar në një sërë parashtrimesh se ekzistonte rreziku real që, nëse liroheshin, të akuzuarit do të orvateshin të pengonin proceset e Gjykatës dhe do të ndërhyenin ndaj dëshmitarëve.

Reagimi i Prokurorit të Specializuar pas verdiktit në gjykimin e Mustafës

Pas vendimit në gjykimin e Salih Mustafës, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting lëshoi një deklaratë në të cilën e përshkroi vendimin si një “fitore për drejtësinë” dhe përshëndeti guximin e treguar nga dëshmitarët. “Ky aktgjykim përfaqëson një fitore për drejtësinë dhe, në veçanti, për viktimat e Salih Mustafës dhe për familjet e tyre, për të gjithë shqiptarët kosovarë, tragjeditë personale të të cilëve ishin në qendër të kësaj çështjeje dhe të cilët kanë vuajtur për më shumë se dy dekada për shkak të veprimeve të z. Mustafa.

“Dëshmitë e dëshmitarëve që patën besim se Dhomat e Specializuara do të vendosnin drejtësi, ishin me rëndësi kyçe për aktgjykimin dhe unë përshëndes guximin e tyre të jashtëzakonshëm që erdhën dhe dhanë dëshmi në gjyq. Krijimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës ka bërë të mundur që këto viktimat të tregojnë atë që u ka ndodhur dhe të marrin drejtësi”, tha Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Uajting.

ZPS-ja gjithashtu përmbushi detyrimet për nxjerrjen e materialeve, të përcaktuara në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para DHSK-së dhe i dha Mbrojtësve të dhënat e 40 dëshmitarëve të parë që do të thirreshin në gjykim.

Gjatë vitit 2022 u mbajtën gjashtë konferenca mbi ecurinë e çështjes, një seancë mbi praktikën e propozuar nga ZPS-ja për trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontaktet me dëshmitarët, si dhe një konferencë përgatitore për gjykimin. Gjithashtu, ZPS-ja dorëzoi 235 parashtrime në lidhje me këtë çështje gjyqësore.

Gjatë gjithë vitit 2022, ZPS-ja vazhdoi thirrjen e dëshmitarëve për t'u intervistuar në Hagë dhe në Prishtinë, mes të cilëve edhe ish-anëtarë të UÇK-së; kreu intervista me dëshmitarë; shqyrtoi të gjitha provat dokumentare të mbledhura gjatë hetimeve dhe i përgatiti ato për t'ua dhënë palëve; dhe punoi me autoritetet përkatëse në organizata ndërkombëtare dhe shtete për të marrë miratimin për përdorimin e tyre në Gjykatë dhe miratimin për dhënien e dëshmive nga dëshmitarët në gjyq.



Prokurorja Valeria Boliçi

Takimet informuese diplomatike dhe veprimtari informimi dhe ndërgjegjësimi

Gjatë vitit 2022, ZPS-ja mori pjesë në një varg takimesh informuese diplomatike për t'ua dhënë shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese informacion të përditësuar mbi punën e ZPS-së, sfidat me të cilat përballëj, dhe mënyrat se si komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmonte që ZPS-ja të përshpejtonte punën e saj.

Në qershor 2022, Prokurori i Specializuar Xhek Smith, së bashku me Kryetaren e DHSK-së Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, zhvilloi një bisedë me Komitetin e BE-së për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave. Në nëntor 2022, në Hagë, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar Aleks Uajting dhe Ushtruesi i Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar Vard Ferdinandys, së bashku me Kryetaren e DHSK-së Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, bënë prezantime për diplomatë nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese. Mbështetja e komunitetit ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet shumë e rëndësishme për aktivitetet e ZPS-së.

Gjithashtu, në tetor 2022, Prokurori i Specializuar Xhek Smith diskutoi mbi punën e ZPS-së me përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Kosova dhe Serbia që janë pjesë e Rrjetit të Informimit të Gjykatës, në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të Dhomave të Specializuara.

4 | Prokurori i Specializuar Xhek Smith

Xhek Smith punoi si Prokuror i Specializuar nga 7 maji 2018 deri më 18 nëntor 2022, kohë gjatë së cilës ai çoi përpara hetimet e ZPS-së dhe mbikëqyri procedimin e dy çështjeve të para gjyqësore në Dhomat e Specializuara. Ai u largua nga ZPS-ja për të marrë një post të nivelit të lartë si Prokuror i Posaçëm në Shtetet e Bashkuara, në të cilin u emërua nga Prokurori i Përgjithshëm Federal i Shteteve të Bashkuara Merrick B. Garland, dhe për të mbikëqyruar procedimin e dy hetimeve penale në vazhdim.

Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Smith ishte zëvendëskryetar dhe shef i seksionit të padive në Korporatën Spitalore të Amerikës, organizata më e madhe joqeveritare e shërbimit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara, post të cilin e mbante që prej shtatorit 2017.

Nga shkurti 2015 deri në gusht 2017, z. Smith ishte ndihmësprokuror i parë federal dhe ushtrues i detyrës së prokurorit federal për rajonin e mesëm në shtetin Tenësi.

Gjatë periudhës 2010-2015, z. Smith drejtoi seksionin për integritet publik në Departamentin e Drejtësisë të SHBA-së, ku ishte i ngarkuar me mbikëqyrjen e procedimit të çështjeve të ndërlikuara të korrupsionit publik në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

Nga viti 2008 deri në vitin 2010, z. Smith ishte koordinator i hetimeve në Zyrën e Prokurorit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN). Në atë funksion ai mbikëqyri hetime delikate të zyrtarëve të qeverive dhe pjesëtarëve të forcave paramilitare për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid.

Përpara se të merrte detyrën në GJPN, z. Smith punoi në Zyrën e Prokurorit Federal për Rajonin Lindor të Nju Jorkut, ku gjatë nëntë viteve shërbeu në poste të ndryshme, përfshirë atë të shefit të zyrës për paditë penale dhe të zëvendëshefit të seksionit penal. Si drejtues i zyrës për padi penale, z. Smith kishte në

vartësi rreth 100 prokurorë penalë në një sërë fushash, ndër të cilat korrupsioni publik, terrorizmi, krimet e dhunshme dhe bandat, si dhe krimi ekonomik dhe mashtrimet financiare komplekse.

Përpara marrjes së detyrës së ndihmësprokurorit federal, z. Smith punoi për pesë vjet si ndihmësprokuror rajonal në Zyrën e Prokurorit të Kontesë së Nju Jorkut, ku shërbeu në seksionet e veprave penale seksuale dhe të dhunës në familje.

Z. Smith u diplomua në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Oneonta dhe gjatë karrierës së tij është nderuar me një sërë çmimesh, si Çmimi i Prokurorit Pro Bono të Vitit të Qendrës për Drejtësi të shtetit Tenësi; Çmimi i Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së; Çmimi i Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA-së për Shërbime të Shquara; Çmimi i Shoqatës Federale të Juristëve për prokurorët e rinj federalë; Çmimi Charles Rose i Shoqatës së Rajonit Lindor; Medalja Henry L. Stimson e Shoqatës së Juristëve të Kontesë së Nju Jorkut; si dhe me bursën Wasserstein të Fakultetit Juridik të Universitetit të Harvardit.



Prokurori i Specializuar Xhek Smith

5 | Kuadri udhëheqës i Prokurorisë

ZPS-ja drejtohet nga një ekip prokurorësh të lartë, që të gjithë me shumë përvojë në juridiksionet e shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare.

Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar është Aleks Uajting (Alex Whiting), prokuror me shtetësi franceze dhe amerikane, me përvojë të gjerë pune në fushën e ndjekjeve penale, si në juridiksione të brendshme, ashtu edhe në ato ndërkombëtare, ku përfshihen periudha pune në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), si dhe me një karrierë të shquar akademike.

Z. Uajting, i diplomuar në Kolegjin dhe Fakultetin e Drejtësisë të Jeillit (Yale), erdhi në ZPS nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Harvardit, ku kishte punuar si profesor i praktikës juridike që prej vitit 2013.

Z. Uajting punoi në Zyrën e Prokurorit të GJPN-së nga viti 2010 deri në vitin 2013, fillimisht si koordinator i hetimeve, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve, dhe më pas si koordinator i procedimeve, përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha procedimeve penale.

Ushtrues i Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar dhe drejtues i Njësisë së Hetimeve të ZPS-së është Vard Ferdinandys (Ward Ferdinandusse), Z. Ferdinandys, me shtetësi holandeze, përfundoi studimet universitare në drejtësi dhe mbrojti doktoraturën në Universitetin e Amsterdimit në fushën e zbatimit të së drejtës penale ndërkombëtarë në gjykatat kombëtare. Ai ka botuar një numër të madh shkrimesh mbi aspekte kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtës penale. Gjithashtu, ai ishte lektor i së drejtës penale ndërkombëtare dhe evropiane në Universitetin e Groningenit, me fokus mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjatë punës së tij si prokuror në Zyrën e Prokurorisë Publike në Rotterdam, z. Ferdinandys u angazhua në



Alex Uajting, Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar

Në TPNJ, ku punoi nga viti 2002 deri në vitin 2007, z. Uajting ishte kryeprokuror në gjykimin e Fatmir Limajt, Isak Musliut, dhe Haradin Balës, dhe kryeprokuror në gjykimet e Millan Martiqit dhe Dragomir Millosheviqit.

Përpara se të punonte në TPNJ, z. Uajting ishte prokuror federal në SHBA, fillimisht në Seksionin Penal të Departamentit të Drejtave Civile në Uashington dhe më pas në Zyrën e Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Boston, Masaçusets, ku u përqendrua në çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.



Vard Ferdinandys, Ushtrues i Detyrës së Zëvendësprokurorit të Specializuar

procedime penale, procedura ekstradimi dhe hetime të krimeve ndërkombëtare si gjenocidi, krimet e luftës, tortura, pirateria dhe terrorizmi. Para se t'i bashkohej ZPS-së, ai ishte kryeprokuror në gjykimin e çështjes lidhur me rrëzimin e avionit MH17.

ZPS-ja ka dy prokurorë të lartë, Alan Tiger (Alan Tieger) dhe Kler Loson (Clare Lawson). Alan Tiger është prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë në SHBA dhe në TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në çështjen e Dushko Tadiqit, edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në çështjen e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Biljana Pllavshiqit.

Nga viti 1987 deri në vitin 1994, z. Tiger ishte prokuror federal në Seksionin Penal të Drejtorisë së të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut (Rodney King).

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoraturës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin e Santa Klarës.

Kler Loson (Claire Lawson), me shtetësi irlandeze, u diplomua në Kolegjin e Universitetit të Dublinit. Gjatë kohës së studimeve ajo kreu një vit specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin e magjistrisë të drejtësisë në Universitetin e Kolumbias. Përpara se të fillonte punën në ZPS, znj. Loson punoi si juriste në Seksionin Gjyqësor të GJPN-së, në Zyrën e Prokurorisë së TPNJ-së, si këshilltare për të drejtat e njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë të njohur avokatie në Irlandë.

Znj. Loson ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, ndër të cilat çështje që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian, dhe ish-Jugosllavinë. Ajo ka kryesuar gjithashtu negociatën për të drejtat e njeriut në emër të BE-së dhe në OKB.



Alan Tiger, prokuror i lartë



Kler Loson, prokurore e lartë

6 | Ekipet e Prokurorisë


Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Mustafës

Në vitin 2022, ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Salih Mustafës përbëhej nga Cezari Mihalçuk (Cezary Michalczuk), Silvia D'Askoli dhe Filipo De Miniçis. Z. Mihalçuk është prokuror polak, i arsimuar në Poloni dhe në Britaninë e Madhe, i cili, ndër të tjera, ka punuar si shef i Seksionit Juridik dhe Sundimit të Ligjit në zyrën e Përfaqësueses së Posaçme të BE-së në Kosovë në vitet 2015-2020, ndërsa në periudhën 2010-2015 ishte shef i Njësisë së Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Znj. D'Askoli është prokurore italiane që ka kryer


doktoraturën në drejtësi, e specializuar në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. Në periudhën 2007-2016 ajo punoi në TPNJ për ndjekjen penale të krimeve të luftës, ndër të tjera edhe në çështjen e Ratko Mladiqit. Z. De Miniçis është ndihmësprokuror italian që më parë ka punuar në TNPJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Korenë e Jugut.



Cezari Mihalçuk, prokuror



Silvia D'Askoli, prokurore




Filipo De Miniçis, ndihmësprokuror


Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Gucatit dhe Haradinajt

Në vitin 2022, ekipi i prokurorisë në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt përbëhej nga Valeria Boliçi, Xhejms Paç dhe Met Holling. Znj. Boliçi është prokurore italiane e cila ka kryer doktoraturën në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare dhe para se t'i bashkohej ZPS-së ka punuar në TPNJ, si prokurore e EULEX-it në Kosovë, si dhe ka ndihmuar për përfaqësimin e Italisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Z. Paç është prokuror maltez, i


arsimuar në Maltë dhe Britaninë e Madhe, i cili më parë ka punuar në zyrën e prokurorisë në Gjykatën e Posaçme të Sierra Leones dhe në GJPN. Z. Holling është prokuror amerikan i miratuar për të ushtruar profesionin e avokatit në gjykatat e Kalifornisë. Ai iu bashkua ekipit të ZPS-së në vitin 2020, me leje të posaçme nga GJPN-ja, ku kishte punuar që prej vitit 2011.



Valeria Boliçi, prokurore



Xhejms Paç, prokuror




Met Halling, prokuror

Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Shalës

Ekipi i prokurorisë në gjykimin e Pjetër Shalës përbëhet nga Filipino De Miniçis, Gaja Pergolo dhe Eva Uajllër. Z. De Miniçis është ndihmësprokuror italian që më parë ka punuar në TNPJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Korenë e Jugut. Znj. Pergolo është ndihmësprokurore italiane, e arsimuar në Itali dhe Britaninë e Madhe, e cila më parë ka punuar në Zyrën e Prokurorit të Mekanizmit Përmbyllës Ndërkombëtar të Tribunalëve Penalë në Hagë; në

kuadër të programit të ndihmës teknike të Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Pnom Pen, Kamboxhia; dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen. Ajo gjithashtu ka punuar për REDRESS, një organizatë joqeveritare që kryen procedime penale në emër të të mbijetuarve të torturës. Znj. Uajllër është ndihmësprokurore zvicerane, e cila më parë ka punuar si avokate në një nga firmat kryesore të avokatisë në fushën e padive penale, hetimit dhe së drejtës penale në Zvicër, dhe si gjykatëse hetuese ushtarake dhe prokurore ushtarake.



Filipo De Miniçis, ndihmësprokuror



Gaja Pergolo, ndihmësprokurore



Eva Uajllër, ndihmësprokurore

Personeli

Personeli i ZPS-së përbëhet nga prokurorë, këshilltarë juridikë, specialistë të sigurisë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe personel mbështetës. Në fund të vitit 2022 ZPS-ja përbëhej nga 72 punonjës, me 21 kombësi të ndryshme, si nga shtetet anëtare të BE-së, ashtu edhe nga shtetet e treta kontribuuese. Nga këta 72 punonjës, 43 ishin meshkuj dhe 29 femra.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS &
SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS RAPORTI I VITIT 2022

Botuar dhe shpërndarë nga:
Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë:
Shqipe, serbishte dhe anglishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së:
www.scp-ks.org

**Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të
Kosovës:**
mediaKSC@scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:
spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike:
Wim Jansen Design
www.wimjansendesign.nl

Shtypur nga
Quantes Grafimedia
www.quant.es.nl

**E drejta e autorit - © 2023 Dhomat e Specializuara dhe Zyra e
Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

Të gjitha të drejtat të rezervuara.



www.scp-ks.org